

# THE KOSOVO BANKER

Përshtatshmëria e  
menaxhimit të rreziqeve dhe  
qeverisja e mirë - Parakushte  
për qëndrueshmërinë e  
bankave

Sfidat e sektorit bankar  
dhe mjedisi ligjor

Forumi Kosovar Kundër  
Mashtrimit me Kartela

Trajnimet në  
Shoqatën e Bankave  
të Kosovës

## QËNDRUESHMËRIA E SISTEMIT BANKAR NË KOSOVË



**ProCredit Bank**



## **Paguaj me Kartelë**

- *Qasje në të hollat tuaja 24 orë në ditë*
- *Realizim të pagesave përmes POS terminaleve*
- *Kartela të pranuar ndërkombëtarisht*

☎ 038 555 555 | 049 555 555 | [www.procreditbank-kos.com](http://www.procreditbank-kos.com)



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKERS' ASSOCIATION

**Banka Ekonomike**



**BANKA PËR BIZNES**  
Mundësi për të gjithë.



**ProCredit Bank**



**Prishtina**



**TEB**



**Raiffeisen  
BANK**

ANËTAR I ASOCIUAR



**FINCA**

## PËRMBAJTJA ✓

### SISTEMI BANKAR (5-12)

■ Editorial ■ Përshtatshmëria e menaxhimit të rreziqeve dhe qeverisja e mirë — Parakushte për qëndrueshmërinë e bankave ■ Qëndrueshmëria e sistemit bankar dhe rritja ekonomike ■ Një vështrim mbi sistemin bankar ■ Fondi për Sigurimin e Depozitave 2

### KËNDI I EKSPERTËVE (14-20)

■ Lobimi dhe avokimi në Shoqatën e Bankave ■ Sfidat e sektorit bankar dhe mjedisi ligjor ■ Avokim për një sistem të shëndoshë ligjor për bankat; Komiteti i pagesave ■ Forumi Kosovor Kundër Mashtrimit me Kartela;

### INTERVISTA (22-28)

■ NLB ka ndikuar në rritjen e konkurrencës së shëndoshë ■ E kemi tundur tregun pozitivisht ■ Objektiv të vazhdojmë rritjen dhe zhvillimin e bankës ■ BKT synon të jetë bankë e rëndësishme rajonale ■ Menaxhimi i një banke vendase — privilegj dhe përgjegjësi

### LAJME (30)

■ Të reja nga bankat ■ BKT me një gamë të gjerë shërbimesh ■ BpB zgjat kredinë deri në tetë vjet ■ Pagesa e TVSH-së përmes TEB e-Banking

### PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE (32-33)

ProCredit Bank mbështet bizneset për të stimuluar zhvillim ekonomik ■ Banka e përkushtuar ndaj ambientit — ProCredit Bank ■ Mijëra nxënës marrin pjesë në ProKid kuizin e diturisë ■ Olimpiada e matematikës ■ BKT kontribuon në zhvillimin e sportit Kosovar

### LAJME NGA SHBK (34-39)

■ Qendra e trajnimeve e Shoqatës së Bankave ■ Tryezë e rrumbullakët ■ Hipoteka si titull ekzekutiv ■ Certifikimi Bazat e Afarizmit Bankar ■ SHBK merr pjesë në panairin e karrierës

### NGJARJET E ARDHSHE (40)

■ Panairi Financiar 2012 ■ Plani i trajnimeve për vjeshtë 2012

## IMPRE SSUM

### BORDI I DREJTORËVE

Z. Robert Wright  
- Kryetar i Bordit,  
Raiffeisen Bank  
Kosovo

Z. Lavdim  
Koshutova -  
NLB Prishtina

Z. Ilir Aliu -  
ProCredit Bank

Z. Alp Yilmaz -  
TEB Bank

### DREJTORE EKZEKUTIVE

Znj. Zana Haxha

### KOORDINATORE E PROJEKTIT

Znj. Saranda  
Spahija

### LEKTOR

Z. Faton Osmani



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKERS' ASSOCIATION

**Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)** është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencën iniciativat ligjore dhe rregullative; koordinon bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për Trajnime Bankare, e cila ofron trajnime në fushën e bankave dhe të financave.

# **starcard** **BUSINESS**

**SHPALOS MUNDËSITË E REJA!**



Shfrytëzoni Biznes Kredit Kartelën  
e dedikuar vetëm për biznesin tuaj.



**TEB**

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

ME KËSTE  
PA KAMATË

**FITO  
BONUS**

teb-kos.com / 038 230 000

# Editorial

## TË NDERUAR LEXUES,

Si kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, kam kënaqësinë të ju mirëpres në edicionin e parë të revistës së shoqatës "The Kosovo Banker".

Në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe të rëndësishëm bankar, me perceptime shpesh të keqkuptuara dhe opinione kontradiktore, është koha e përkryer për të nisur një revistë që do të ndihmojë në sqarime, gjenerime të analizave dhe diskutimeve nga një spektër i gjerë i palëve të interesit, institucioneve dhe konsumatorëve, si dhe të kontribuojë në rritjen pozitive dhe mirëqenien e industrisë bankare të Kosovës.

Ky edicion i parë i revistës ofron një shembull të shkëlqyer të gjerësisë dhe shtrirjes së sektorit bankar, sepse kemi kontribute nga drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes Bankare në Bankën Qendrore të Kosovës, z. Merdian Kukleci; z. Lumir Abdixhiku, Drejtor Ekzekutiv i Institutit Riinvest; z. Hajdar Korbi, Zëvendës-drejtor i Bankës për Biznes, si dhe znj. Violeta Arifi-Krasniqi, Drejtoreshë Ekzekutive e Fondit për Sigurim in e Depozitave.

Sektori bankar në Kosovë kurrë më parë nuk ka qenë në një situatë kaq pozitive dhe të sigurt, siç është sot. Sektori është fitimprurës, i kapitalizuar mirë dhe i rregulluar me kujdes, i mbikëqyrur në përputhje me standardet e BE-së dhe me një ekspozim shumë të kufizuar ndaj rrezikut të borxhit në monedhë të huaj, ose kërcënimeve të tjera, me të cilat shumë sektorë bankarë të eurozonës po përballen sot.

Shikuar nga perspektiva e konsumatorit, nivelet e depozitave janë më të larta se kurrë më parë, me më shumë se dy miliardë euro të depozituara në llogaritë bankare, në fund të vitit 2011.

Shumat e kredive, gjithashtu, kanë arritur nivele rekorde në fund të vitit 2011 me pothuajse 1.6 miliardë euro dhe asetet totale të bankave pothuajse janë dyfishuar në këto katër vjet, për të arritur një shumë prej 2.4 miliardë euro, në fund të vitit të kaluar.

Për të plotësuar këtë kërkesë të konsumatorëve, kanalet e shpërndarjes së bankave vazhdojnë të zgjerohen dhe tani në Kosovë ka mbi 300 filiale, në shtesë të rreth 350 bankomatëve, mijëra terminaleve të shitjes

për transaksionet me kartela dhe ka një rritje të përdorimit të internetit dhe të teknologjisë së telefonisë celulare për shërbimet bankare. Kosova ende mbetet prapa vendeve të tjera për sa i përket përdorimit të kanaleve bankare elektronike, sidoqoftë përdorimi është duke u rritur ndjeshëm dhe teknologjia po bëhet gjithnjë e më e përdorueshme dhe e lehtë për t'u shfrytëzuar.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, është e qartë se sektori bankar është në një situatë pozitive dhe të shëndetshme, gjë që është e dobishme, si për ekonominë ashtu edhe për vendin. Sidoqoftë, kjo nuk duhet të na bëjë të relaksuar. Efektet e krizës së eurozonës mund të ndikojnë ende në Kosovë dhe ka shumë



ROBERT WRIGHT  
KRYETAR I BORDIT  
TË SHOQATËS  
SË BANKAVE TË  
KOSOVËS

aspekte të ekonomisë lokale që janë të brishta dhe mund të shndërrohen në ndikime negative në afat të shkurtër apo të mesëm të tilla si papunësia, inflacioni ose reduktimi në rritjen e Bruto Prodhimit të Brendshëm (BPB). Sektori bankar, pra do të vazhdojë me një qasje të kujdesshme dhe të matur ndaj kreditimit, do të inkurajojë kursimet në të gjitha sektorët e bazës së klientëve tanë dhe ne,

gjithashtu, do të vazhdojmë të përmirësojmë shërbimin ndaj konsumatorëve dhe të zgjerojmë rrjetet tona të shpërndarjes.

Anëtarët e Shoqatës së Bankave, po ashtu, do të vazhdojnë të punojnë me palët e ndryshme të interesit, grupet e konsumatorëve, komunitetet dhe palët e tjera të interesuara, të cilët janë të përfshirë në sistemin bankar, për të ndihmuar në rritjen dhe zhvillimin e vendit, derisa në të njëjtën kohë do të vazhdojmë të jemi sektori bankar që është bërë zili për shumë vende të tjera në rajon.

Lexim të këndshëm!

# Përshtatshmëria e menaxhimit të rreziqeve dhe qeverisja e mirë - Parakushte për qëndrueshmërinë e bankave

Rritja e vëllimit dhe kompleksitetit të produkteve dhe shërbimeve bankare doemos parashtron nevojën e rritjes paralele të kapaciteteve menaxhuese.

**SEKTORI BANKAR NË KOSOVË**, dihet mirëfilli se është i ri dhe në zhvillim. I sendërtuar pas vitit 1999, sektori bankar ka vazhduar të rritet duke shërbyer si aktor kryesor ndër-mjetësimi financiar dhe duke ruajtur qëndrueshmërinë e komponentëve përbërës të likuiditetit, profitabilitetit dhe kapitalit. Ndonëse me një ritëm më të ngadalësuar rritjeje krahasuar me vitet paraprake, gjatë vitit 2011, sektori bankar u rrit për 8.1% në mjetet gjithsej. Dinamika e rritjes u karakterizua me vazhdimin e konsolidimit të sektorit, përkatësisht rritjes së peshës së bankave të vogla<sup>1</sup>, degëve të bankave të huaja<sup>2</sup> dhe rënies së lehtë të peshës së bankave të mëdha<sup>3</sup>. Struktura e mjeteve vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin e kredidhënies. Gjithsej portofoli kreditor përbën rreth 62% të gjithëj mjeteve të sektorit bankar.

Rritja e vëllimit dhe kompleksitetit të produkteve dhe shërbimeve bankare, doemos parashtron nevojën e rritjes paralele të kapaciteteve menaxhuese. Në fakt, bankat kanë një detyrim publik për t'iu përmbajtur standardeve dhe praktikave ndërkombëtarisht të pranuar për menaxhimin e rreziqeve dhe qeverisjen e mirë. Si institucione financiare që pranojnë depozita nga publiku, bankat kanë detyrime kujdesi ndaj shumë aktorëve, përfshirë depozitarët, kreditorët, rregullatorin, aksionarët, madje edhe vetë bankat e tjera, ngase dështimi i një banke mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e të gjithë sektorit financiar.

I ekspozuar kryesisht ndaj rrezikut kreditor, me ofertë të bankingu tradicional, dhe duke operuar në një mjedis



MERDIAN  
KUKLECI

DREJTOR I  
DEPARTAMENTIT  
TË MBIKËQYRJES  
BANKARE, BANKA  
QENDRORE E  
REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS

jo mirë të përkrahur nga mekanizmat e nevojshëm të zgjidhjes së kontesteve kreditor-debitor, sektori bankar ka ruajtur kreditë joperformuese në nivele të menaxhueshme. Niveli i kredive joperformuese prej 5.7% është ndër më të ulët në rajon dhe më i qëndrueshmi për sa i takon variacioneve ndër vite<sup>4</sup>. Ruajtja e këtij niveli është mundësuar nga ngritja e kapaciteteve menaxhuese të rrezikut kreditor, orientimeve të qarta në përzgjedhjen me kujdes të sektorëve dhe klientëve për t'u kredituar dhe mbikëqyrjes së përafërt të përshtatshmërisë së menaxhimit të rreziqeve nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, rol me rëndësi në ofrimin e informacionit për performancën e kredimarrësve vazhdon të luajë Regjistri i Kredive të Kosovës.

Megjithatë, mbetet hapësirë e konsiderueshme për fleksibilitet nga ana e bankave në drejtim të nxitjes së performancës së klientëve, edukimit të publikut, e me këtë përkrahjen e vetë qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Ndër alternativat që mund të kualifikohen për konsideratë është fleksibiliteti në koston e përgjithshme të financimit, duke ia kushtëzuar dhe përshtatur atë klientëve që performojnë mirë, ata të cilët i përmbahen kushteve dhe afateve të kontraktuara me bankën. Ndër mësimet e nxjerra nga kriza e fundit financiare është edhe koncepti i zgjerimit të misionit të bankave, nga ai i fokusit në "maksimizimin e fitimeve" drejt një vizioni të rritjes së "përgjegjësisë ndaj të gjitha palëve të interesit". Zotimi për qëndrueshmëri financiare kërkon nga bankat të integrojnë orientimet e tyre strategjike në përgjegjësinë shoqërore dhe ridefinimin e

1 Bankat në pjesëmarrje prej <10% të gjithëj mjeteve të sektorit bankar

2 Dy bankat, e inkuorporuara në treg si "degë" të bankave të huaja

3 Bankat në pjesëmarrje prej >10% të gjithëj mjeteve të sektorit bankar

4 Niveli i kredive joperformuese gjatë tri viteve të fundit; 2009 =4.4%; 2010=5.9%; 2011=5.7%

konceptit të rrezikut, duke e zgjeruar atë me përgjegjësi ndaj të gjitha palëve të interesit.

Element kyç për qëndrueshmëri, pa dyshim se është ruajtja e likuiditetit dhe kapitalit. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të qëndrojë mirë i kapitalizuar dhe likuid. Niveli i kapitalit të peshuar me rrezik prej rreth 18%, mbetet ndjeshëm mbi kërkesat rregullore prej 12%. Për më tepër, struktura e kapitalit është cilësore e përbërë në rreth 80% nga kapitali i klasit të parë<sup>5</sup>. Performanca e mirë e fitimeve, në nivel prej 37 milionë euro në fund të 2011, vazhdon të përkrahë qëndrueshmërinë e kapitalit të bankave.

Likuiditeti i sektorit bankar vazhdon gjithashtu të jetë i kënaqshëm. Aktualisht, mjetet likuide në gjithsej mjetet, marrin pjesë me 31%, duke mbuluar 37% të gjithsej depozitave dhe 35% të gjithsej detyrimeve. Raporti i kredive ndaj depozitave prej 81% është brenda kufirit të rekomanduar prej 80%. Struktura e depozitave gjithashtu është e favorshme, me ç'rast depozitat<sup>6</sup> bazë përbëjnë rreth 85% të gjithsej depozitave. Për më tepër, përshtatshmëria e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit është e kënaqshme. Ky kualifikim është dëshmuar, sidomos në rastin e tërheqjes së mjeteve likuide nga sektori bankar, gjatë dy viteve të fundit, në shumë prej rreth 200 milionë eurove nga depozitat e Postës dhe Telekomit të Kosovës, të paguara si dividendë Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me gjithë përshtatshmërinë dhe avancimin e menaxhimit të rreziqeve, qeverisja e bankave duhet të forcohet në përbërjen e bordeve, në përcaktimin e orientimeve strategjike, evitimin e "konflikteve të interesit", për të përkrahur qëndrueshmëri dhe qasje më transparente ndaj klientëve. Jo rrallë, strategjitë e bankave janë vëllimore dhe të orientuara drejt rritjes së pjesëmarrjes në treg, pa llogaritur në kombinimin e resurseve të nevojshme njerëzore dhe kapitale. Bordet drejtuese të bankave mbeten kryesisht "borde të aksionarëve", prandaj nevojitet pjesëmarrje më e madhe e anëtarëve të pavarur - të jashtëm në bordet drejtuese për të sjellë "tension produktiv", transparencë dhe përshtatshmëri në qeverisje.

Në këtë kontekst, Ligji i ri për Bankat, zgjeron më tej

fushëveprimin e rregullatorit ndaj bankave dhe institucioneve të tjera të mbuluara<sup>7</sup>. Ndër risitë e promovuara me këtë ligj është edhe forcimi i kriterëve të qeverisjes, në veçanti "Përbërja e bordeve drejtuese", kërkesa që shumica e anëtarëve të jenë anëtarë të pavarur dhe joekzekutiv dhe që një ndër anëtarët të jetë rezident. Kërkesa për anëtarë rezident është parashtruar të jetë në funksion të përfaqësimit lokal në bordet e bankave të huaja, në drejtim të artikullimit më të mirë të strategjive zhvillimore të bankave, në harmoni me strategjitë zhvillimore të vendit dhe specifikat e tregut; Komitetet e Bordeve Drejtuese -

përcaktimi i komitetit për menaxhimin e rreziqeve dhe të komiteteve tjera; Forcimi i kriterëve të "testeve të përshtatshmërisë" për administratorët e institucioneve financiare (anëtarët e bordeve drejtuese dhe menaxhmentit të lartë); "Ekspozimet e mëdha". Pragu maksimal i përcaktuar me ligj; 15% nga 20% sa ka qenë më parë, dhe përqendrimi i depozitave njëburimore në nivelin prej 20% të gjithsej depozitave; "Ekspozimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën", duke mandatuar rregullatorin të aplikojë zbritjen e drejtpërdrejtë nga kapitalit të

çdo shume mbi limitin e përcaktuar dhe duke demotivuar kështu përqendrimin e ekspozimeve ndaj një grupi, apo më shumë, klientësh të ndërlidhur me bankën.

Ligji i ri për bankat forcon gjithashtu edhe kërkesat për kapitalizimin dhe likuiditetin e bankave. Minimumi i kapitalit të paguar është rritur në nivelin prej 7 milionë euro, nga 5 milionë sa ishte, dhe bankat obligohen të mbajnë këtë minimum gjatë gjithë kohës së operimit të tyre në treg.

Gjithashtu, në harmoni me ligjin, rregulloret e reja bankare parashohin peshimin edhe të rrezikut operacional me faktorë rreziku, përkatësisht mbulueshmërinë me kapital, sipas metodës së indikatorëve bazik dhe metodës standarde si dhe rifreskimin e faktorëve të rrezikut, konform ndryshimeve të fundit në nivel ndërkombëtar. Përshtatshmëria e likuiditetit, gjithashtu është përcaktuar në harmoni me standardet më të reja të Komitetit të Baselit për Mbikëqyrje Efektive Bankare, duke i ridefinuar kërkesat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe përcaktuar indikatorët e detyrueshëm financiar të mbulueshmërisë së likuiditetit.



5 Rregullorja e BQK-së për mjaftueshmëri të kapitalit - kapitali i klasës së parë "aksionet e thjeshta; aksionet e preferuara dhe fitimet e pashpërndara"

6 Gjithsej depozitat, minus depozitat mbi 1% e gjithsej depozitave

7 Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Jobankare



# Qëndrueshmëria e sistemit bankar dhe rritja ekonomike

Se rritja dhe qëndrueshmëria ekonomike varet nga stabiliteti i sistemit bankar, është vërtetuar edhe nga kriza e fundit financiare. Si pasojë e kësaj krize, normat e rritjes ekonomike, në shumë vende u zvogëluan, e në shumë të tjera ishin negative.

**RRITJA E QËNDRUESHME** ekonomike është një nga objektivat kryesore të pothuajse të gjitha bankave qendrore dhe qeverive të shteteve. Megjithatë, një numër i madh i vendeve ballafaqohen me vështirësi të theksuara në drejtim të gjenerimit të rritjes ekonomike dhe mbajtjen e ritmit pozitiv për një periudhë më të gjatë.

Përderisa historikisht teoritë mbi rritjen ekonomike kanë vënë në pah një numër të faktorëve që ndikojnë në rritjen dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë së një vendi, në përgjithësi ekziston pajtueshmëria se fuqia punëtore, kapitali dhe produktiviteti, duke marrë parasysh edhe ndryshimet teknologjike, janë faktorët kryesorë që bëj-



HAJDAR  
KORBI

ZËVENDËS  
DREJTOR I  
PËRGJITHSHËM,  
BANKA PËR  
BIZNES

në që një ekonomi të rritet më shpejt, apo më ngadalë.

Më pas, ka një numër të madh të faktorëve të tjerë që ndikojnë në kualitetin e fuqisë punëtore, kualitetin e kapitalit, produktivitetin dhe ndryshimet teknologjike. Tregjet financiare, e në veçanti tregu bankar dhe qëndrueshmëria e tij, është një nga faktorët që në masë të madhe e kushtëzon zhvillimin ekonomik të një vendi. Në të vërtetë, duket se në një masë të madhe, stabiliteti i njëjës e kushtëzon tjetrën, por mbi të gjitha nuk mund të ketë rritje të qëndrueshme ekonomike pa një sistem të qëndrueshëm bankar - *ky edhe është fokusi i këtij shkrimi.*

Se rritja dhe qëndrueshmëria ekonomike varet nga stabiliteti i sistemit bankar, është vërtetuar edhe nga kriza e fundit financiare. Si pasojë e kësaj krize, normat e





rritjes ekonomike, në shumë vende u zvogëluan, e në shumë të tjera ishin negative; papunësia u rrit në masë të konsiderueshme, kthimi nga kursimet dhe investimet u zvogëlua dukshëm dhe qasja në burime të financimit u vështirësua tej mase.

Nëse ka një lidhshmëri aq të theksuar midis stabilitetit bankar dhe qëndrueshmërisë ekonomike, atëherë si mund të sigurohemi se kemi një sistem bankar të qëndrueshëm dhe mbështetës të rritjes ekonomike. Ka një numër faktorësh që ndikojnë në dinamizimin dhe stabilitetin e sistemit bankar. Duhet thënë se sistemi bankar si i tillë është mjaft më ndryshe dhe më specifik nga sistemet e tjera, kryesisht për shkak të llojit të veçantë të shërbimeve dhe produkteve që ofron për klientelën e vet. Ndjeshmëria e këtij sistemi nga lëvizjet në treg është shumë e madhe, dhe në këtë drejtim, rregullatori duhet të ketë një vëmendje të veçantë.

Marrë si tërësi, bazë për një sistem të qëndrueshëm bankar është kapitalizimi, likuiditeti, qeverisja korporative dhe mbikëqyrja efektive nga rregullatori. Njëra pa tjetrën nuk bën. Mund të kemi një sistem të mbikapitalizuar, por problemet me likuiditet rrezikojnë stabilitetin e tij, sikurse që një mbikëqyrje joefektive nga rregullatori, mund të rezultojë në probleme serioze të funksionimit të institucioneve individuale bankare apo të sistemit, si tërësi. Në të vërtetë, një nga arsyt kryesore të dështimit të funksionimit normal të sistemeve financiare, në shumë vende të botës, nga kriza që filloi në vitin 2007, ishte pikërisht mungesa e një mbikëqyrje efektive nga rregullatorët.

Përderisa iniciativa ndërkombëtare, kryesisht të udhëhequra nga "Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare", kanë bërë që ndërkombëtarisht të arrihet deri te një pa-

jtueshmëri lidhur me atë se cili është kapitali i mjaftueshëm, çfarë norma të likuiditetit janë të pranueshme, si duhet të duket qeverisja korporative e një sistemi bankar, e kështu me radhë. Përvoja nga e kaluara na tregon se rregullatori i sistemit bankar duhet të jetë vazhdimisht aktiv dhe kërkesat rregullative të përshtaten me ecuritë dhe nevojat e mjedisit.

Sa i përket Kosovës, sistemi i saj bankar është relativisht i ri, por me një performancë të kënaqshme. Që nga themelimi i Bankës Qendrore, e më pas licencimi i bankave komerciale, sektori bankar në vazhdimësi ka zgjeruar llojllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve që ofron në treg, ka përmirësuar kualitetin e shërbimeve dhe performancën dhe ajo çka është më e rëndësishmja, ka kontribuar në masë të madhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Përkundër krizës financiare, që para ca viteve ishte e pranishme në shumë shtete të zhvilluara dhe përkundër krizës së tanishme buxhetore të disa vendeve të eurozonës, sektori bankar në Kosovë nuk është prekur shumë nga efektet e këtyre krizave. Dhe marrë si tërësi, mund të thuhet se ky sistem është i shëndoshë dhe me premisa për të vazhduar me qëndrueshmërinë e tij dhe rrjedhimisht për të vazhduar me kontributin në rritjen ekonomike të vendit. Shkalla e ulët e integritit financiar me tregjet e jashtme ka bërë që tregu bankar i Kosovës të mos ndikohet direkt nga kriza financiare e para ca viteve, ndërsa faktorët e përmendur më lart, të tillë si kapitalizimi, likuiditeti, qeverisja korporative dhe mbikëqyrja nga rregullatori, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në nivel.

Në të vërtetë, lirisht mund të thuhet se funksionimi efektiv dhe stabiliteti i sistemit bankar të vendit, si një nga parakushtet kryesore për një rritje të qëndrueshme ekonomike, kanë kontribuar dhe do të vazhdojnë të kontribuojnë në masë të madhe në rritjen ekonomike të Kosovës.

Megjithatë, duhet të kihet parasysh fakti se kriza buxhetore që ka kapluar një numër të shteteve të eurozonës, ka krijuar një huti tek investitorët, dhe rrjedhimisht, shumë nga ekonomitë e eurozonës po përballen me vështirësi të theksuara të rritjes ekonomike.

Përkundër disa veprimeve në drejtim të menaxhimit më të mirë të kësaj krize dhe përkundër ideve për një union fiskal, që do të menaxhonte më mirë buxhetet e shteteve individuale, vazhdon të ketë pasiguri në mesin e investitorëve, gjë që në mënyrë direkte po ndikon në rritjen ekonomike të vendeve të eurozonës. Prandaj, duke pasur parasysh faktin se ekonomia e Kosovës është shumë e hapur ndaj ekonomisë së eurozonës, performanca e saj do të varet në masë të konsiderueshme nga ecuria e ekonomive të këtyre vendeve, ndërsa varësisht se si performon ekonomia e Kosovës, do të ketë ndikim direkt edhe në sistemin bankar. Kjo patjetër sinjalizon rregullatorin për një vëmendje të shtuar, me qëllim që efektet e mundshme të krizës së eurozonës në ekonominë e Kosovës të ndihen sa më pak në sistemin bankar të Kosovës.

# Një vështrim mbi sistemin bankar



LUMIR  
ABDIXHIKU

DREJTOR EKZEKUTIV,  
INSTITUTI RIINVEST

Pa dashur të gjejë fajtorin në këtë shpërputhje entropike, më duhet të argumentojë në tri fusha thelbësore, të cilat, për mendimin tim, përbëjnë arsyen e këtyre barrierave. Të tri fushat fatkeqësisht burojnë mu nga akterët e interakcionit: bizneset, bankat dhe vetë shteti.

**I NISUR NGA ASGJËJA**, sistemi bankar i Kosovës sot mund të mburret me themelet e vëna dhe këtë ecje të vogël ndër vite, por mjaft të qëndrueshme. Trembëdhjetë vjet më parë, ai ballafaqohej me ankthin më të tmerrshëm që një sistem mund ta kishte, humbjen e besimit. Kosovarët, herën e fundit që bashkëvepronin me bankat, kishin humbur të gjitha kursimet dhe çdo kthim në këtë sistem, domosdo kërkonte një paraqitje e bindje përtej të zakonshmes.

Trembëdhjetë vjet më pas, mosbesimi në sistemin bankar është i rrallë. Për më tepër, bankat kosovare janë bërë strofull i mijëra të punësuarve, shembull i një menaxhimi modern, atraksion i karrieristëve bankarë dhe facilitator i krijimit të një industrie të tërë përcjellëse, në shërbim të gjithë sistemit. Raportet e institucioneve kredibile ndërkombëtare tregojnë për një qëndrueshmëri financiare, përkundër valës së krizave, ndërkaq analizat vendore mbështesin një ecje të qetë dhe stabile në tërësi.

Por, para se t'i japim medaljen e suksesit bankingut kosovar, duhet ndërruar pak dioptrinë e syzeve. Përkundër një qëndrueshmërie ndër vite, interaksioni ndërmjet bankave dhe kosovarëve vazhdon të çalojë thelbësisht. Koshtoja e financimit dhe qasja në financa, sot vazhdojnë të jenë barrierat thelbësore në bërjen e biznesit, duke marrë parasysh tharjen e tregut nga paraja, ato bëhen dhe më të rënda. Pa dashur të gjejë fajtorin në këtë shpërputhje entropike, më duhet të argumentojë në tri fusha thelbësore, të cilat, për mendimin tim, përbëjnë arsyet e këtyre barrierave. Të tri fushat fatkeqësisht burojnë mu nga aktorët e interakcionit: bizneset, bankat dhe vetë shteti.

Të parët, pra bizneset, bëhen fajtorë për mënyrën e të bërit biznes. Një stil sa tradicional, e sa evaziv, lë pak vend për bankat që të bëjnë vlerësimin korrekt të gjendjes së bizneseve. Në një vend ku evazioni fiskal arrin 40%, ku



pasqyrat financiare të bizneseve janë fantome, identifikimi i fuqive biznese nga vlerësuesit bankar, jo vetëm se bëhet i pamundur, por dhe kur mundësohet, bëhet i shtrënjtë. Përveç kësaj, disiplina e bërjes së transaksioneve nëpërmjet sistemit bankar shënon rekordet më të ulëta në Evropë. Pa këto transaksione, ndërtimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet dy aktorëve është i pamundur. Një biznes që ka një historik transaksionesh me një bankë, ka gjasa shumëherë më të mira për qasje në financa.

Të dytët, pra bankat, bëhen fajtorë për mungesën e motiveve konkurruese. Me apo pa dëshirë, status-quoja e tyre në ndërrimin e normave të interesit bëhet handicap për të gjithë. Bankat kosovare ka vite që pranojnë komfortin e një mosshtryeje, e një gjendje kaq e qetë (në kuptimin e konkurrencës) s'ka se si të bëjë uljen e kostos së kapitalit. Edhe më pak inkurajuese bëhen divergjencat në shërbime dhe kostot e shfrytëzimit të shërbimeve të bankave të tjera nga klientët e tjerë. Për shembull, të rralla janë praktikat, ku bankomatët renditen si vagonë treni; një treg konkurrues do të bënte unifikimin e tyre, duke ulur kështu barrierat jolicencore.

Të tretët, pra institucionet shtetërore, bëhen fajtorë për mosaftësinë e tyre për të siguruar një mjedis të qetë e të sigurt biznesor. Me nivelin e tanishëm të zhvillimit ekonomik, me rregreset e shumta në mjedisin biznesor, me

paaftësinë e krijimit të mekanizmave gjyqësorë, normat e interesit marrin arsyeshmërinë e plotë të tyre. Në fund të fundit, ato vetëm se reflektojnë në riskun e marrë. Rikujtoni se në Kosovë, një rast bankar trajtohet njëjtë me një rast trafik. Për më tepër, rikujtoni se vetëm 3% e bizneseve shfrytëzojnë shërbimet e gjyqësorit (përkundër 38% e mesatares në rajon); një sistem i tillë kaq anarkik s'ka se si të prodhojë kosto më të ulët financimi. Përveç kësaj, imazhi ekonomik që dërgojmë jashtë, pakëson mundësinë e tërheqjes së investitorëve seriozë, edhe në tregun financiar.

Në të gjitha rastet, defektet e secilit prej aktorëve bëjnë një kosto të padurueshme për kosovarët, bizneset e tyre dhe ekonominë në tërësi. Pa financim të lirë (në kosto) për iniciativat e reja, zhvillimet e zgjerimet e bizneseve ekzistuese, bujqësisë e prodhimtarisë në veçanti, rigjenerimi ekonomik i Kosovës do të jetë i pakët. Arritja e një financimi të lirë duhet të jetë prioritet i politikëbërjes sonë. Ky prioritet duhet të përmbajë një frymë më pozitive të të gjithë aktorëve, e që në esencë kanë për qëllim krijimin e konkurrencës në sektorin bankar, përmirësimin e filozofisë biznese dhe ndërrimin radikal të performancës ekonomike të Kosovës. Deri atëherë, vlerësimi i rolit të sektorit bankar në Kosovë do të shihet si një dilemë e një gote gjysmë të mbushur, apo gjysmë të zbratur.

# Fondi për Sigurimin e Depozitave

FSDK-ja siguron 872 mijë llogari të depozitorëve dhe shumën prej 299 milionë euro, nga gjithsej 2 miliardë e 61 milionë euro, që janë në sistemin bankar.

**SIGURIMI I DEPOZITAVE** nënkupton nivelin e siguruar të depozitit, i cili është i garantuar për t'iu kompensuar depozitorit të siguruar, në rast të likuidimit të bankës. Qëllimi kryesor i sistemit të sigurimit të depozitave është mbrojtja e depozitarëve, duke mbështetur kështu stabilitetin e sektorit financiar në vend, si një komponent i rëndësishëm i rrjetit të sigurisë financiare dhe duke mbajtur besimin në sektorin bankar.

Sistemi i parë i sigurimit të depozitave është themeluar në SHBA, në vitin 1933; në Evropë ka filluar në vitin 1994, ndërsa në rajon në vitet 2000.

Në Kosovë, sigurimi i depozitave ka filluar nga data 25 maj 2011, pas tri vitesh pune të inicuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe e përkrahur nga Republika Federale e Gjermanisë (përmes KfW-së). Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë është formuar në bazë të Ligjit për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare, Ligji Nr.: 03/L-216, me qëllim të mbrojtjes së depozitorëve të vegjël nga humbja, në rast të likuidimit të ndonjë banke, si dhe të mbështesë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në arritjen e qëllimit të saj për rritjen e sigurisë, solvencës dhe funksionimin efikas të një sistemi stabil, të bazuar në ekonominë e tregut. Fondi për Sigurimin e Depozitave në Kosovë (FSDK) është entitet ligjor, i cili është përgjegjës për menaxhimin e Fondit për Sigurimin e Depozitave.

Mandati kryesor i FSDK-së është të sigurojë depozitat e personave fizikë dhe atyre juridikë, deri në 2,000 EURO dhe të kompensojë çdo depozitor të siguruar, deri në shumën e siguruar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, në rast të likuidimit të ndonjë banke. Përgjegjësitë e tjera të FSDK-së janë: caktimi i nivelit të premieeve dhe arkëtimi i tyre; investimi i asetëve të fondit; bashkëpunimi me BQK-në në shkëmbimin e informacioneve dhe huamarrja në raste emergjente.



VIOLETA  
ARIFI-KRASNIQI

DREJTORESHË  
MENAXHUESE  
FONDI I SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE NË  
KOSOVË

FSDK-ja është institucion i pavarur, i cili i raporton Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe qeveriset nga Bordi Menaxhues, me këtë përbërje: Guvernatori i BQK-së, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, eksperti i sigurimit të depozitave, Auditori i licencuar dhe drejtori Menaxhues i FSDK-së.

FSDK-ja siguron 872 mijë llogari të depozitorëve dhe shumën prej 299 milionë euro, nga gjithsej 2 miliardë e 61 milionë euro, që janë në sistemin bankar.

## FSDK ka gjithsej shtatë (7) banka anëtare\*

1. Banka Ekonomike
2. Banka Kombëtare Tregtare
3. Banka për Biznes
4. NLB Prishtina
5. ProCredit Bank Kosovë
6. Raiffeisen Bank Kosovë
7. TEB SH.A.

\*Renditja sipas alfabetit

euro për kapitalizimin e fondit si dhe 0.5 milionë euro, në formë të asistencës teknike për tre vitet e ardhshme, me qëllim të zhvillimit institucional të FSDK-së.


Në përgjithësi, themelimi i Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë është shumë i rëndësishëm dhe shënon një progres për shtetin e Republikës së Kosovës si komponentj të rëndësishme që kontribuon në qëndrueshmërinë e sistemit bankar, duke fuqizuar besimin e depozitorëve.



BANKA PËR BIZNES

mundësi për më shumë...

## Shërbime elektronike



# Lobimi dhe avokimi në Shoqatën e Bankave

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës funksionojnë tetë komitete/grupe punuese, të fushave të ndryshme të sektorit bankar. Komitetet përbëhen nga ekspertë të fushës bankare të shtatë bankave komerciale, anëtare të shoqatës. Profili i ekspertëve bankarë i përshtatet aktivitetete të këtyre grupeve punuese. Këto komitete kanë rol këshillues për shoqatën dhe menaxhmentin e bankave, për çështje që ndikojnë funksionimin më të mirë të sektorit.

Komitetet organizojnë takime të shumta, varësisht nga tema që trajtohet, me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, gjykatat, Këshillin Gjyqësor, Institutin Gjyqësor, Agjencinë Kadastrale, Administratën Tatimore, ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë këtu agjencitë të cilat funksionojnë në kuadër të këtyre ministrive, dhe me të gjitha organizatat e tjera, që për bazë të aktivitetit të tyre kanë sektorin financiar në Kosovë.

Komitetet kanë bashkëpunim edhe me institucione të tjera ndërkombëtare, siç është VISA dhe forume të tjera të ngjashme në vendet e rajonit, qëllimi i së cilave është shkëmbimi i informatave, përvojave dhe diskutimeve për zhvillimin e mëtutjeshëm të ekspertizës bankare.

Komitetet organizojnë takime të rregullta me përfaqësuesit e VISA-së dhe marrin pjesë rregullisht në aktivitete të ndryshme, siç janë punëtoritë dhe konferencat rajonale.

## Tetë komitetet funksionale në Shoqatën e Bankave të Kosovës janë

1. Komiteti i Thesarit;
2. Komiteti Kundër Shpëlarjes së Parave;
3. Komiteti për Çështje Ligjore;
4. Komiteti i Pagesave;
5. Forumi Kundër Mashtrimeve me Kartela;
6. Komiteti i Sigurisë;
7. Komiteti i Financave;
8. Komiteti i Marketingut.

Gjatë vitit 2012, komitetet kanë qenë të angazhuara në grupet punuese qeveritare dhe në ato të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për hartimin dhe/ apo amendamentimin e ligjeve dhe rregulloreve, të cilat janë me interes për sektorin financiar. Projektligjet dhe rregulloret në të cilat Shoqata e Bankave të Kosovës ka dhënë kontributin e saj janë:

### Komiteti Ligjor

- Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare;
- Projektligji për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme;
- Rregullorja për Regjistrin e Mbajtësve të Llogarive Bankare.

### Komiteti i Pagesave dhe Forumi Kundër Mashtrimeve me Kartela

- Projektligji i Sistemit të Pagesave;
- Draft-rregullorja për Kushtet e Veçanta të Shërbiemeve të Pagesave Ndërkombëtare;
- Draft-udhëzimi për Identifikim Unik të Urdhërpagesave Ndërkombëtare Dalëse.

# Sfidat e sektorit bankar dhe mjedisi ligjor

**SEKTORI BANKAR**, si një ndër sektorët më të zhvilluar dhe më të qëndrueshëm në Kosovë, mund të thuhet se paraqet një ndër tregimet më të suksesshme në Kosovën e pasluftës. Mirëpo, me gjithë këtë zhvillim dhe këto arritje të sektorit bankar, problem dhe një ndër sfidat kryesore mbetet edhe më tutje mjedisi ligjor/ligjet dhe praktikat e zbatimit të ligjeve, të cilat në një mënyrë ose tjetër rregullojnë dhe prekin veprimtarinë dhe biznesin e sektorit bankar në Kosovë.

Para së gjithash, në Kosovë, ende kemi një dualizëm të ligjeve (ligjet që janë aprovuar nga UNMIK-u dhe ligjet e reja të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës) që rregullojnë veprimtarinë bankare, të cilat shpesh shkaktojnë konfuzion tek gjyqtarët me rastin e zbatimit të ligjit, përkatësisht me rastin e vendosjes sipas propozimeve, padive të bankave në një procedurë të përbarimit të pengut dhe hipotekës.

Shpesh ky problem bëhet edhe më i madh kur gjykatat komunale, si gjykata të shkallës së parë dhe gjykatat e qarkut, si gjykata të shkallës së dytë, marrin qëndrime dhe vendosin në mënyra të ndryshme, përkritazi me çështjet e njëjta juridike, në fushën e procedurës së përbarimit të pengut të luajtshëm dhe atij të paluajtshëm. Shpeshherë këto praktika të ndryshme të gjykatave në Kosovë i shkaktojnë probleme të mëdha sektorit bankar dhe vonesa të paarsyeshme në realizimin e të drejtave të ligjshme, që kanë të bëjnë me kthimin e borxheve të këqija.

Sfidë tjetër shumë e shpeshtë e sektorit bankar është edhe joefikasiteti i gjykatave në trajtimin e rasteve të sektorit bankar. Shpesh ndodh që nga propozimi për ekzekutim të pengut dhe hipotekës, deri në lejimin e ekzekutimit, kalojnë gjashtë muaj - deri në dy apo tre vjet, gjë që i shkakton probleme funksionimit normal të sistemit të kreditimit dhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me vonesat në ripagimin e kredive të këqija, faktorë këta që ndikojnë indirekt edhe në ekonominë e Kosovës. Pastaj kemi edhe veprimet burokratike të zyrtarëve të gjykatave, me rastin e legalizimit dhe të vërtetimit të kontratave, autorizimeve, deklaratave dhe dokumenteve të tjera të bankave, me ç'rast shkaktohen zvarritje dhe pengesa të paarsyeshme në formalizimin e këtyre kontratave.

Edhe në rastet kur bankat arrijnë të ekzekutojnë hipotekat, pra bëhen pronarë të tyre, bankat nuk mund t'i shesin këto hipoteka dhe t'i shndërrojnë në para të gatshme, për shkak të mentalitetit konservativ dhe tradicional që ekziston te popullata në Kosovë, ku askush nuk preferon të blejë prona "me probleme".

Përveç ballafaqimit të sektorit bankar me sfidën



JAKUP HOTI

MENAXHER I  
DEPARTAMENTIT  
LIGJOR NË BANKËN  
KOMBËTARE TREGTARE

e përmendur në raport me gjykatat, ky sektor jorrallë ballafaqohet edhe me sfida jo të vogla edhe me zyrat komunale kadastrale në Kosovë, të cilat zyra ndjekin praktika të ndryshme për sa i përket regjistrimit/intabulimit të hipotekave, duke zvarritur shpesh këto procese pa arsye dhe duke u sjell në mënyrë burokratike.

Një tjetër sfidë, ose problematikë, me të cilën përballlet sektori bankar paraqitet edhe tek mosdefiniimi i pronave, mungesa e regjistrave kadastralë, mosregjistrimi në regjistra kadastralë i gjendjes faktike (ka raste kur prona është shitblerë, ndërsa prona nuk është bartur/regjistruar në emër të pronarit të ri). Të gjitha këto situata të paqarta në sferën e pronësisë ua bëjnë shpeshherë bankave të pamundshëm financimin e bizneseve, ose edhe personave fizikë, të cilët ende nuk e kanë të rregulluar dokumentacionin pronësor.

Duke parë një ambient të tillë ligjor që përbën sfidë reale për sektorin bankar, sektori bankar ka krijuar një mekanizëm në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës, të quajtur Komiteti Ligjor, anëtarët e të cilit kujdesen që të marrin pjesë drejtpërdrejt në përpilimin e projektligjeve që prekin sektorin bankar, duke u përpjekur kështu që të ofrojnë ekspertizën e tyre profesionale, në mënyrë që ligjet të ofrojnë një siguri më të madhe juridike për aktivitetet e bankave.

Në përgjithësi, me gjithë përpjekjet që po bëhen nga të gjithë - institucionet shtetërore, prezenca ndërkom-bëtare në Kosovë, grupet e interesit dhe ekspertët e fushave të ndryshme - për përmirësimin e ambientit ligjor, reformimin e sistemit gjyqësor dhe të sistemit juridik në tërësi, që në një mënyrë ose tjetër, prek sektorin bankar, konsideroj që mbetet ende shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim, në mënyrë që të sigurojmë një mjedis ligjor të duhur dhe të përshtatshëm për funksionimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit bankar.

# Avokim për një sistem të shëndoshë ligjor për bankat

Komiteti Ligjor përbëhet nga tetë anëtarë, përkatësisht avokatë, nga secila bankë komerciale anëtare e Shoqatës së Bankave të Kosovës.

**KOMITETI LIGJOR ËSHTË** themeluar më 4 shkurt 2010. Roli kryesor i tij është që të avokojë dhe të lobojë në emër të bankave komerciale, të licencuara nga Banka Qendrore për të vepruar në Kosovë, në lidhje me çështje të ndryshme ligjore, të cilat kanë ndikim në bankat dhe aktivitetet e tyre të përditshme të biznesit. Po ashtu, ai siguron mbështetje profesionale për grupet e punës, të cilat janë të përfshira në hartimin e legjislacionit dhe të rregulloreve.

Komiteti Ligjor përbëhet nga tetë anëtarë, përkatësisht avokatë, nga secila bankë komerciale, anëtare e Shoqatës së Bankave të Kosovës. Puna e Komitetit Ligjor është goxha sfiduese, për të thënë më së paku. Puna në një ekonomi në tranzicion, ku shumë procese duke përfshirë këtu edhe sistemin juridik, u janë nënshtruar reformave të mëdha, është një detyrë me rëndësi dhe Komiteti Ligjor i përmbush sfidat e saja në këtë proces. Komiteti Ligjor, në emër të bankave komerciale, avokon për çfarëdo çështje ligjore, apo administrative, të cilat propozohen nga ana e institucioneve kombëtare, po ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare.

Ndikimi në vendimmarrësit, si dhe promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të bankave komerciale, është vizioni kryesor i misionit tonë. Ne synojmë të promovojmë dhe të avokojmë për një sistem të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe të drejtë ligjor dhe rregullator, i cili i mbështet bankat komerciale që veprojnë në Kosovë. Ne angazhohemi dhe marrim pjesë në shumë iniciativa ligjore që qeveria ndjek, për të siguruar që zëri i bankave dëgjohet. Komiteti Ligjor takohet rregullisht në zyrat e Shoqatës së Bankave të Kosovës, me ç'rast diskutohet për çështje të ndryshme.

Pjesëmarrja e Komitetit në të gjithë projektet e legjislacionit është shumë e rëndësishme, sepse pjesëmarrësit të cilët janë zgjedhur nga Komiteti Ligjor, kontribuojnë në proces, duke dhënë ekspertizën e dorës së parë nga sektori bankar komercial. Kjo ekspertizë, jo vetëm që është e vlefshme kur kemi të bëjmë me hartimin e legjislacionit, por pjesëmarrja jonë zakonisht kontribuon duke vënë përpara problemet që hasin bankat në praktikë, apo do të hasin me legjislacionin e propozuar. Disa prej ligjeve në të cilat ne kemi kontribuar janë: Ligji për Bankat, Ligji



PREVEZA  
MUHARREMI

DREJTUESE E  
DEPARTAMENTIT LIGJOR  
NË PROCREDIT BANK.  
KRYETARE E KOMITETIT  
LIGJOR NË SHOQATËN E  
BANKAVE TË KOSOVËS

për Detyrimet, Ligji për Procedurat Ekzekutive, Projektligji për Plotësimin e Pengut në Regjistrin e Pasurisë së Luajtshme dhe Projektligji për Pagesat.

Komentet tona janë me rëndësi, sepse ekspertiza që jepet nga ne është vendimtare për procesin e hartimit të një ligji. Megjithatë, duhet të theksohet se Komiteti Ligjor has në shumë pengesa përgjatë procesit. Për shembull, projektligjet që na dërgohen për t'u komentuar, na dërgohen në minutën e fundit dhe me një kohë shumë të kufizuar brenda të cilës ne duhet të përgjigjemi. Analizimi i ligjeve është një proces i gjatë dhe me rëndësi për shkak se shumë aspekte duhet të merren në konsideratë, duke përfshirë këtu edhe analizën lidhur me implikimet në veprimtaritë bankare, prandaj afati i shkurtër kohor i dhënë ndaj Komitetit Ligjor zakonisht pengon kontributin tonë konstruktiv. Veç kësaj, shpesh ndodh që komentet e Komitetit Ligjor të shpërfillen dhe të mos merren parasysh fare, duke i bërë ligjet e miratuara të jenë ngarkesa dhe të vështira për t'u respektuar. Nga përvoja e kaluar, e dimë se shumë ligje ose rregullore që u dekretuan mbetën të heshtura, sepse korniza e zbatimit, thjesht mungonte.

Për më tepër, Komiteti Ligjor përfaqëson bankat në konferenca, tryeza të rrumbullakëta dhe gjithashtu takime të natyrave të ndryshme, ku çështjet e ngritura nga ana e bankave diskutohen dhe merren për bazë. Inputet e Komitetit Ligjor janë të një rëndësie të posaçme për proceset ligjore që ndërmerren nga institucione të ndryshme në Kosovë. Një platformë e qëndrueshme ligjore në Kosovë është parakusht për të ardhmen e Kosovës drejt integritimit evropian. Kjo do të jetë e dobishme jo vetëm për komunitetin e biznesit në Kosovë, por po ashtu do të ketë ndikim në rritjen e mundshme ekonomike dhe rritjen e investimeve të huaja të mundshme, të cilat janë shumë të nevojshme në Kosovë.

Komiteti Ligjor i Shoqatës së Bankave të Kosovës ka një rrugë të gjatë përpara, megjithatë, do të mbetet aktiv dhe do të jetë zëri kryesor lobues dhe avokues për të siguruar një mjedis të shëndoshë ligjor në Kosovë, i cili është i domosdoshëm për funksionimin e duhur të bankave.





Ku ti je në rradhë të parë!



# Komiteti i pagesave

Skema e Debitimit Direkt është një projekt, i cili u mundëson qytetarëve, respektivisht klientëve të bankave komerciale, të bëjnë pagesat mujore (të rrymës, të telefonit, të ujit) në mënyrë elektronike, përmes llogarive të tyre bankare.

**KOMITETI I PAGESAVE**, ka filluar të funksionojë që nga viti 2009 dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, përkatësisht përfaqësues të bankave komerciale. Themelimi i këtij komiteti ka ndikuar shumë pozitivisht në sektorin bankar, meqë zhvillimet e reja në tregun bankar përcillen për së afërti nga të gjithë anëtarët e komitetit, të cilët bashkëpunojnë ngushtësisht mes vete për një synim pozitiv. Anëtarët e komitetit janë persona të zgjedhur dhe me përvojë të gjatë pune në këtë fushë dhe të gjithë kontribuojnë në zhvillimet e reja në sistemin e pagesave.

Ky komitet mban takime të rregullta, katërpesë herë në vit, duke mos përjashtuar edhe takime të

tjera shtesë, të cilat paraqiten të nevojshme për diskutim. Në disa takime të komitetit marrin pjesë edhe zyrtarë të BQK-së dhe të institucioneve të tjera, me të cilët diskutohen bashkërisht temat/pikat që kanë të bëjnë me sistemin e pagesave. Komiteti i Pagesave ka karakter këshillues, ku të gjithë anëtarët japin mendimet, këshillat dhe sugjerimet e tyre. Në të gjitha takimet e mbajtura arrihet një vendim në marrëveshje me të gjithë përfaqësuesit e bankave, me qëllimin që vendimet të jenë shumë të shëndosha për tregun në përgjithësi dhe të ndikojnë pozitivisht në sistemin e pagesave, respektivisht që të gjithë klientët të kenë shërbime sa më të mira të



VALBONA  
DURAKU

MENAXHERE E  
PAGESAVE NË TEB  
BANK. KRYETARE  
E KOMITETIT TË  
PAGESAVE NË  
SHOQATËN E BANKAVE  
TË KOSOVËS

pagesave. Vlen të theksohet se Komiteti i Pagesave i kushton rëndësi të madhe edhe krijimit dhe zhvillimit të produkteve të reja, në mënyrë që klientëve t'u ofrohet lehtësi më e madhe në procesimin e pagesave.

Lidhur me zhvillimet e takimeve të deritanishme, do të përmend skemën e Debitimit Direkt, që është një projekt i madh dhe shumë i rëndësishëm për sistemin e pagesave, e që është trajtuar dhe diskutuar gjatë në Komitetin e Pagesave. Me zhvillimin e këtij projekti, përkatesisht bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet BQK-së, të gjitha bankave komerciale dhe kompanive të mëdha si KEK, PTK dhe KUR (Kompania e Ujësjellësit Rajonal) është arritur procesimi i faturave në mënyrë të automatizuar, gjë që ka ndikuar në evitimin e page-

save në para të gatshme. Skema e Debitimit Direkt është një projekt, i cili u mundëson qytetarëve, respektivisht klientëve të bankave komerciale, të bëjnë pagesat mujore (të rrymës, të telefonit, të ujit) në mënyrë elektronike, përmes llogarive të tyre bankare. Fillimisht duhet të arrihet (nënshkruhet) marrëveshja ndërmjet konsumatorit/klientit dhe kompanisë publike (apo dhe private) dhe i gjithë procesi tjetër kryhet në mënyrë automatike. Prandaj, inkurajoj të gjithë klientët e të gjitha bankave që janë në marrëdhënie pune, të përdorin shërbimin e Debitimit Direkt, në mënyrë që të paguajnë të gjitha faturat saktë, shpejt dhe sigurt.

Gjithashtu, anëtarët e komitetit kanë treguar angazhimin e tyre edhe lidhur me pagesat e pagave/rrogave që duhet proce-

suar përmes shërbimit të quajtur moduli masiv. Qëllimi i të gjithë anëtarëve ka qenë që të gjitha pagat të procesohen përmes modulit masiv, shërbim i cili ofrohet nga të gjitha bankat. Vazhdimisht është treguar vullneti i mirë i punës në këtë drejtim, në mënyrë që të rritet volumni i procesimit të pagave nëpërmes këtij moduli.

Në takimet e fundit të komitetit është diskutuar edhe për pagesat e pensionistëve (pensionet), takim i zhvilluar bashkërisht me zyrtarët e BQK-së dhe zyrtarët e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (MPMS). Gjatë këtij takimi, të gjithë anëtarët e komitetit janë pajtuar njëzëri dhe kanë kërkuar nga MPMS-ja që t'u lejojë të gjithë pensionistëve shfrytëzimi i llogarive të tyre edhe për shërbime tjera, meqë marrëveshja aktuale ndërmjet MPMS-së dhe bankave komerciale lejon që llogaria e pensionistëve të përdoret vetëm për pranimin e pensionit. Sidoqoftë, pas gjithë diskutimit në këtë takim, kërkesa e anëtarëve të komitetit është dërguar edhe zyrtarisht në adresën e MPMS-së dhe tani jemi në pritje të përgjigjes së tyre me shpresë që t'u mundësohet edhe pensionistëve përdorimi dhe shfrytëzimi i të gjitha produkteve bankare, ashtu sikurse iu ofrohet të gjithë klientëve të tjerë.

Komiteti ka diskutuar me kujdes të veçantë edhe Projektligjin e Pagesave. Anëtarët e Komitetit kanë analizuar gjatë dhe në mënyrë të detajuar këtë

projektligj dhe kanë dhënë bashkërisht komentet e tyre në të gjitha aspektet lidhur me pagesat. Dhe falë bashkëpunimit të mirë me BQK-në, të gjitha komentet e dhëna janë marrë parasysh dhe tani Projektligji

i Pagesave është duke u rishqyrtuar, edhe njëherë, nga anëtarët e Komitetit.

Suksesi i këtij komiteti rezulton shumë në nxitjen dhe rritjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave. Megjithatë, në për-

fundim mund të them se objektivi dhe fokusi kryesor i Komitetit të Pagesave është që të punojë në drejtim të arritjes së funksionimit sa më të mirë të sistemit të pagesave në përgjithësi.

MARKETING

**ASSECO**  
SOUTH EASTERN EUROPE

Asseco SEE d.o.o.  
Veternik, Industrial Zone, pn  
10 000 Prishtina, Kosovo  
Ph: + 381 38 55 77 99  
www.asseco-see.com

**Veçoritë e aplikacioneve mobile të Assecos**

- Thjeshtë, shpejtë, sigurt
- Implementime te shumëfishta
- I pavarur nga operatori mobil
- I pavarur nga rrjeta mobile
- Trafik i ulët i të dhënave – Shpenzime të ulëta të shërbimit
- Ekip i zhvilluesve me përvojë
- Përkrahje direkte [Wiki, You Tube]
- Përkrahje e fuqishme lokale përmes Asseco grupacionit

**Tipet e tel. mobil që përkrahen:**

**+1.300**

Java / Android / iOS / BlackBerry / WP7

# Forumi Kosovar Kundër Mashtrimit me Kartela

Forumi kontribuon në zhvillimin dhe mbrojtjen e integritetit të pagesave me kartela, duke trajtuar gjithashtu kornizat legjislative dhe rregullative.

**FORUMI KOSOVAR** Kundër Mashtrimit me Kartela është themeluar dhe funksionon në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës, për më shumë se katër vjet. Ky forum ka anëtarë nga të gjitha bankat, shumica e të cilave janë emetuese dhe blerëse të Kartelave Visa dhe Master. Përfaqësuesi rajonal i VISA-s shpesh është, po ashtu, pjesë e takimeve dhe zhvillimeve në këtë forum.

Forumi Kosovar kundër Mashtrimit me Kartela kontribuon kryesisht në zhvillimin e mbrojtjen e integritetit të pagesave me kartela, duke trajtuar mashtrimin me kartela dhe gjithashtu kornizat legjislative dhe rregullative. Është e rëndësishme të theksohet se funksioni kryesor i forumit është që të ndihmojë në bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve pjesëmarrës në luftën kundër mashtrimit, si dhe zhvillimin e praktikave më të mira.

Aktivitetet e parandalimit të mashtrimit janë synimet kryesore të këtij forumi. Ka pasur një numër aktivitetesh që ky forum ka ndërmarrë deri më tani:

1. NJË NGA INICIATIVAT ISHTE MARRËVESHJA për futjen në listë të zezë të tregtarëve me raport mashtrimi më të madh se normal, ose të përcaktuar në marrëveshje, si dhe krijimi i një baze të dhënash për shkëmbim të informacionit. Kjo marrëveshje e nënshkruar në vitin 2009 nga Emetuesit dhe Blerësit e Kartelave Visa dhe Master, ka për qëllim parandalimin e mashtrimit dhe futjen në bazën e të dhënave tregtarëve që kanë kryer transaksione mashtruese. Ajo gjithashtu kontrollon nëse tregtarët e rinj nuk janë në listën e zezë, sikurse që rregullon edhe dispozita të tjera kontraktuese. Baza e të dhënave do t'i mundësojë industrisë bankare që të shkëmbejë informacione në të gjitha mashtrimet e konfirmuara, në tentativë dhe dyshuese, në një bazë të përbashkët të dhënash duke ndihmuar kështu industrinë në strategjinë e saj afatgjatë në parandalimin e mashtrimit.

2. PROJEKTIGJI PËR KRIMIN NË INTERNET. Ne kemi pasur takime me bankat dhe me autorët e Projektligjit për Krimin në Internet, duke sugjeruar ndryshime apo pika të reja në përbërjen e tij, të cilat mund t'i shtohen këtij ligji, në mënyrë që ai të përfshijë praktikën më të mira për t'i trajtuar krimet e kryera me kartela bankare, nëpërmjet llojeve të ndryshme të mashtrimit.



MODEST MORINA

SPECIALIST PËR  
MONITORIMIN E  
MASHTRIMEVE ME KARTELA  
NË RAIFFEISEN BANK.  
KRYETAR I KOMITETIT  
KUNDËR MASHTRIMEVE ME  
KARTELA NË SHOQATËN E  
BANKAVE TË KOSOVËS

3. TRAJNIMI PËR POLICINË DHE PERSONELIN GJYQËSOR. Për të promovuar njohuritë e tij mbi Kartelat Mashtruese, Forumi Kundër Mashtrimit me Kartela mbajti trajnimin e parë në vitin 2011 për policinë dhe njësitë e tyre në luftën e tyre kundër Krimin në Internet, si dhe për gjyqtarët dhe prokurorët. Qëllimi ishte që të shpjegojmë mbi llojet e mashtrimit me kartela, se si ato ndodhin, dhe se si mund të parandalohen. Kjo ka kontribuar në masë të madhe në njohjen e faktorëve kyç në luftën kundër mashtrimit me kartela dhe gjithashtu njohjen e personave nga fusha të ndryshme, që janë duke kontribuar në këtë drejtim.

Një përfitim tjetër i madh për kauzën tonë ishte shkëmbimi i informacionit ndërmjet anëtarëve të policisë (Njësisë Kundër Krimin në Internet) dhe bankave, si dhe arritja e marrëveshjes për raportimin e rasteve të ndryshme të ndërlidhura me "Mashtrimin me Kartela".

Si rezultat i kësaj ka pasur një rënie në mashtrime, si dhe bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve, vazhdon të jetë i dobishëm për të dyja palët.

4. SISTEMET E AVANCUARA TË MONITORIMI TË TRANS-AKSIONIT. Një nga diskutimet në Forumin Kundër Mashtrimit me Kartela ka qenë zbatimi i Sistemeve të Avancuara të Autorizimit të përdorura për monitorim, që di sa nga bankat veç kanë filluar t'i zbatojnë. Sistemi do të përdoret për të vendosur parametra në sistemin e autorizimit, për të parandaluar apo zvogëluar, numrin e transaksioneve mashtruese.

5. PJESËMARRJA NË FORUMET RAJONALE. Forumi Kosovar Kundër Mashtrimit me Kartela ka qenë i ftuar dhe ka marrë pjesë në Forumin Shqiptar Kombëtar Kundër Mashtrimit, të mbajtur në Tiranë, i cili mbulon zhvillimet kryesore të industrisë, si nga aspekti teknik, po ashtu dhe nga ai i menaxhimit, si dhe nga aspekti i parandalimit të mashtrimit dhe metodave të hetimit. Theks i veçantë është vënë në nevojën për bashkëpunim të ndërsjellë midis bankave dhe autoriteteve për të nxitur zhvillimin e sigurt të kësaj industrie.

NLB Kredi



# NLB Kredi për Banesë, Truall apo Shtëpi

Aplikoni në NLB Prishtina për:  
Kredi për blerje të banesës  
Kredi për ndërtimin e shtëpisë  
Kredi për blerjen e truallit

Kredi deri  
**150.000 €**  
deri  
**180 muaj**

**Deri në 20.000 Euro pa hipotekë**  
**Mundesi e aplikimit online me e-klik**

**NLB**  **Prishtina**  
*Ë di pse*

# Intervista



## NLB KA NDIKUAR NË RRIJTJEN E KONKURENCËS SË SHËNDOSHË

### ALBERT LUMEZI

KRYESHEF EKZEKUTIV, NLB PRISHTINA

#### Si e ka ndihmuar shkrirja e dy institucioneve (BRK dhe KSB) Bankën NLB Prishtina?

Sektori bankar në Kosovë, në disa vite të fundit, ka vazhduar me ndryshime pozitive, me stabilizim të më-tutjeshëm, me forcim, rritje dhe zhvillim, ndërsa matur me treguesit më të rëndësishëm kuantitativë dhe kualitativë, është ruajtur trendi i përmirësimit në të gjitha segmentet e afarizmit. Grupi NLB, si një ndër liderët rajonal në sektorin financiar dhe si një bankë me rëndësi evropiane, me praninë e saj ka ndikuar në dinamizimin dhe rritjen e konkurrencës së shëndoshë në tregun bankar të Kosovës. Në fillim të korrikut të vitit 2007, Grupi NLB u bë pronare e shumicës së aksioneve të Bankës së Re të Kosovës. Pasi që Kasabank, edhe më parë, ishte anëtare e Grupit NLB që nga prilli 2007, integrimi i këtyre dy bankave në hapësirën e

Kosovës, është një hap i logjikshëm. Në favor të bashkimit të këtyre dy bankave flasin faktorë të numërt, të cilët kanë paralajmëruar fitimin e një kualiteti të ri në tregun bankar të Kosovës. Me shkrirjen në një bankë fitohet një institucion më i fuqishëm financiar dhe realizohen këto qëllime:

- Rritja e aktivës dhe kapitalit themelor, gjë që ka ndikuar pozitivisht në rejtingun dhe aftësinë e bankës së përbashkët në tregun e Kosovës;
- Garantimi i sigurisë më të madhe në afarizëm;
- Realizim i profitit më të madh;
- Racionalizimi i shpenzimeve;
- Mbulimi më i madh i tregut dhe racionalizimi i rrjetit afarist;
- Rritja e aftësisë konkurruese;
- Krijimi i kushteve për ofrimin e shërbimeve një numri më të madh të klientëve me produkte kreditore dhe shërbime financiare;
- Përmirësimi i sistemit të

qeverisjes së rreziqeve, duke disponuar sasi më të mëdha të informatave për klientët;

- Shfrytëzim më i plotë i resurseve në dispozicion.

#### Cilat janë përparësitë dhe të metat e shkrirjes dhe blerjes së institucioneve, duke konsideruar rastin tuaj?

Me procesin e bashkimit të bankave mundësohet realizimi më i lehtë i qëllimeve strategjike të listuara më lart. Përparësitë kryesore janë: koncentrohesh kapitali pronësor, forcohet siguria në afarizëm, rritet likuiditeti, solventshmëria dhe profitabiliteti, si dhe sigurohet zhvillimi i më-tutjeshëm dhe stabiliteti i Bankës, në mënyrë më efikase dhe funksionale. Ndërsa të metat kryesore janë: shpenzimi i energjisë në harmonizimin e afarizmit dhe akteve normative, si dhe trashëgimi i problemeve të bankave paraardhëse.

#### Cilat janë qëllimet e bankës suaj për vitin 2012?

Objektivat kryesorë të bankës për periudhën e ardhshme të planifikimit janë:

- Promovimi i një imazhi të mirë të Grupit NLB;
- Të bëhet urë lidhëse në mes të ekonomisë slllovene dhe kosovare, si dhe shteteve ku është prezent Grupi NLB;
- Të mbajë pjesëmarrjen aktuale në treg, dhe të pranohet nga publiku si një nga liderët kryesorë të industrisë bankare;
- Të ketë shtrirjen më të madhe përgjatë territorit të Kosovës;
- Të mbajë bazën e klientëve dhe arrijë rritjen e volumit afarist;
- Vazhdimi i rritjes së kujdesit ndaj klientit – zhvillimi dhe implementimi i një qasjeje sistematike dhe fleksibile ndaj menaxhimit të klientëve;
- Produkte/shërbime të reja për klientët (kreditë, depozitat, e-banking, kartelat, bankingu personal etj.)



## E KEMI TUNDUR TREGUN POZITIVISHT

### ALP YILMAZ

KRYESHEF EKZEKUTIV, TEB SH.A.

#### Cilat janë synimet e Bankës TEB për vitin 2012?

- Gjatë këtyre katër vjetëve të fundit, sinqerisht mund të them se Banka TEB në Kosovë është bërë një nga lojtarët kryesorë në sektorin financiar. Kemi lansuar produkte të shumta të reja, të cilat janë mjaft unike për tregun. Për të gjithë ne në Bankë, ofrimi i shërbimeve cilësore ndaj klientëve është një nga parakushtet më të rëndësishme për mbajtjen e klientëve të kënaqur. Edhe pas plot katër vjetëve, ne ende jemi të frymëzuar, sikurse në ditët e para, kur sapo kishim filluar ta ndërtonim brendin tonë, si ofruesi më cilësor i shërbimeve në sektorin financiar. Mund të themi se kemi qenë shumë të mirëpritur këtu dhe treguesit më të mirë për këtë janë pothuajse 150.000 klientët tanë, të të gjitha segmenteve. Synimi ynë për të ardhmen është që të mirëmbajmë një rritje të qëndrueshme dhe solide si dhe të rrisim cilësinë e shërbimeve në vitet

në vijim.

#### Si ka qenë procesi i hyrjes në tregun e Kosovës? Cilat ishin sfidat?

- Kur ne vendosëm të investojmë në vitin 2007, Kosova ende nuk ishte e pavarur. Sidoqoftë ishte shumë premtuese në drejtim të aspiratave. Ishte e qartë se Kosova synonte të arrinte dhe të ruante standartet ndërkombëtare në çdo fushë. Për më tepër, sektori financiar ende nuk ishte i ngjeshur dhe dominonin vetëm dy lojtarë ndërkombëtarë. Në atë kohë, ne menduam se do të mund të bënim një transferim të ekspertizës dhe përvojës së BNP-së dhe TEB-it në Kosovë. Në të njëjtën kohë, kishte lidhje të ngushta historike, kulturore dhe ekonomike ndërmjet Turqisë dhe Kosovës. Ishte kjo një shtysë tjetër për ne dhe sigurisht se ka ndihmuar në integrimin tonë në sektorin financiar. Para se të hynim në treg, ne shpesh kemi vizituar Kosovën, për ta

ngjohur atë dhe tregun më për së afërmi. Gjatë kësaj kohe, ne kemi pasur takime me zyrtarë qeveritarë, Bankën Qendrore dhe institucionet ndërkombëtare. Pra, nuk pati ndonjë surprizë dhe ne ishim mirë të përgatitur për të përmbushur të gjitha kërkesat rregullative. Më duhet, po ashtu, të them se si investues të huaj, ne kemi marrë shumë mbështetje dhe ndihmë për të qenë në përputhje me rregulloret. Me pak fjalë, ne nuk u përballëm me ndonjë vështirësi të veçantë që do ta ngadalësonte hyrjen tonë në treg.

#### Si ndryshuan gjërat pas katër vjetësh veprimi në këtë treg?

- Janë bërë gati 4 vjet e gjysmë qëkur filluam veprimin. Në këtë periudhë, ne themeluan një institucion me reputacion ndërkombëtar financiar, me gati 10% pjesë të tregut në sektorin bankar. Bazuar në reagimet pozitive nga klientët tanë, ne vërtet besojmë që e kemi tundur tregun, në një

mënyrë shumë pozitive. Megjithatë, nga pikëpamja makroekonomike, ka ende sfida që Kosova duhet trajtuar menjëherë. Sipas studimit "Të Bësh Biznes në Kosovë", përparimi në krijimin e një mjedisi pozitiv ndërmarrës është i ngadalshëm. Sundimi i ligjit dhe zbatimi i tij, është ende një nga bllokuesit kryesor, që dekurajon investimet e mëtejshme të huaja direkte. Megjithatë, ne kemi parë përparim të konsiderueshëm në infrastrukturën e përgjithshme, si dhe në investime të tjera publike. Me një normë të tillë të lartë të papunësisë dhe të ardhurave për banor, rritja e BPV-së (Bruto Prodhimit Vendor) ka pësuar një trend pozitiv, edhe gjatë krizës së tanishme globale. Duke pasur parasysh mbështetjen e vazhdueshme të Evropës, SHBA-së dhe Turqisë, ne jemi të sigurt në potencialin dhe perspektivën e Kosovës, sikurse ishim në vitin 2007.



## PROCREDIT BANK ME NJË VIZION TË FUQISHËM ZHVILLIMOR

### ILIR ALIU

KRYESHEF EKZEKUTIV, PROCREDIT BANK

#### 1) Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha për ProCredit Bankën në vitin 2011?

Përkundër krizës së vazhdueshme në tregjet financiare ndërkombëtare, viti 2011 ishte vit i suksesshëm për ProCredit Bankën. Rezultatet e arritura në vitin që lamë pas, dëshmojnë se është e mundur të qenit i suksesshëm komercialist dhe njëkohësisht të ruhet qasja e orientuar drejt zhvillimit. Duke qenë në harmoni me misionin e vet, ProCredit Banka ka vazhduar të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes kredive dhe shërbimeve bankare të bazuara në nevojat individuale të bizneseve, si dhe në fushën e depozitave për qytetarët e Kosovës. Viti 2011 ishte vit jo vetëm i rritjes/zgjerimit të aktiviteteve tona bankare në Kosovë, por edhe një vit i kontributit tonë në informimin dhe edukimin e qytetarëve për shërbimet bankare. Me mbështetjen e Bankës Qendrore të Kosovës ne kemi ndërmarrë iniciativë vetëdijësimi në fushën e informimit të publikut për

shërbimet bankare sepse besojmë fuqimisht se është absolutisht thelbësore që publiku i gjerë të ketë njohuri themelore në lidhje me bankat dhe shërbimet e tyre.

#### 2) Cilat janë qëllimet e bankës suaj për vitin 2012?

Cilësia e shërbimeve të ProCredit Bankës është dëshmuar me suksesin e punës sonë duke qenë jo vetëm banka e parë në Kosovën e pasluftës, por edhe më e suksesshme që nga viti 2000. Cilësia e institucionit tonë është dëshmuar me çmimin 'Banka më e mirë për vitin 2011', nga revista prestigjioze 'The Banker' që është pjesë e grupit Financial Times. Titullin e bankës më të mirë në Kosovë, edhe për vitin që kaloi, e kemi marrë po ashtu nga Euro Money, që ndan çmimin për ekselencë të performancës bankare. Këto vlerësime që i bëhen punës sonë dhe shërbimeve tona bankare janë tregues për profesionalizmin dhe qëndrueshmërinë e ProCredit Bankës në tregun bankar të Kosovës. Mos të harrojmë që sek-

tori bankar në Kosovë është ndër shtyllat kryesore të tregut financiar, të tregut kapital, dhe rrjedhimisht performanca e secilës bankë ka ndikim në zhvillimet financiare në tregun e vendit tonë. Prandaj, ne si ProCredit Bank jemi krenarë duke qenë shembull i mirë se si një institucion me vizion të fuqishëm zhvillimor, në të njëjtën kohë mund të jetë edhe shumë i suksesshëm komercialist. Në këtë kontekst, ProCredit Bank në vitin 2012 po i avancohet tjetër shërbimet e veta bankare dhe do të plasojë në treg teknologjitë më të reja duke qenë kështu në hap me kohën. Realizimi i qëllimeve tona është në harmoni të plotë me vlerat unike dhe misionin e bankës sonë, duke qenë shembull i një institucioni të përgjegjshëm financiar që ndërton kulturë të kursimeve dhe partneritetit afatgjatë me klientët. Të mos harrojmë se gjithë kjo punë është bërë dhe do të bëhet nga stafi i ProCredit Bankës, prandaj profesionalizmi i tyre është një ndër asetet tona kyçe. Në vitin 2012, ne do të vazhdo-

jmë me Programin për Bankierë të Rinj dhe programet tjera trajnuese duke bërë investime të mëdha në trajnimin e stafit. Të qenit pjesë e ekipit të ProCredit Bankës do të thotë avancim i vazhdueshëm i shkathtësive dhe njohurive, vetëm e vetëm për të krijuar atmosferë të ngrohtë dhe efikase të punës, si dhe të ofrojmë shërbime kompetente për klientët tanë. Si një institucion i përgjegjshëm financiar dhe ekologjikisht miqësor, ProCredit Bank edhe në 2012 do të vazhdojë të iniciojë dhe përkrahë shumë iniciativë të shumta në të mirë të shoqërisë, qofshin ato në fushën e edukimit, mbrojtjes mjedisore, aftësisë së kufizuar, kulturore, sportive, e të tjera.



# Audit · Tax · Advisory

- √ audit
- √ business risks
- √ mergers and acquisitions
- √ recovery and reorganization
- √ project finances
- √ transaction advisory services
- √ asset and business valuations
- √ tax services
- √ financial outsourcing
- √ IFRS training



Grant  
Thornton

**Do you wish to be confident in your business?  
Do you wish to take your business to a higher  
level?**

Our team of competent professionals will provide you with a variety of assurance and business-advisory services to fully meet all your business needs! Grant Thornton will deliver integrity and help you to identify, assess and control your business risks, this providing an overall and accurate review of your business performance.

Grant Thornton will support you to make your business a success!

For more information about our services, please contact us at:

Grant Thornton LLC  
Rexhep Mala 18  
10000 Prishtina  
Kosovo

T + 381 38 247 801  
F + 381 38 247 802  
E [gtkosovo@grant-thornton.com.mk](mailto:gtkosovo@grant-thornton.com.mk)

[www.grant-thornton.com.mk](http://www.grant-thornton.com.mk)



**Grant Thornton**

An instinct for growth™

Audit · Tax · Advisory

## OBJEKTIV TË VAZHDOJMË RRRITJEN DHE ZHVILLIMIN E BANKËS



### ROBERT WRIGHT

KRYESHEF  
EKZEKUTIV,  
RAIFFEISEN BANK  
KOSOVË

#### Cilat ishin sfidat më të mëdha për Raiffeisen Bank në vitin 2011?

Sfidat më të mëdha në vitin 2011 ishin të lidhura me menaxhimin e pasigurisë dhe paparashikueshmërinë e ekonomive evropiane dhe lokale. Pasojat e mundshme të krizës greke, rregullat e reja, kërkesat e bankave në eurozonë dhe ekonomia e brishtë e Kosovës, mund të ishin kombinuar për të krijuar një situatë komplekse dhe shumë të vështirë. Fatmirësisht, kjo nuk ishte rasti dhe mjedisi ishte relativisht pozitiv. Dhe, në vitin e përfunduar me rezultate të shkëlqyera.

#### Cilat janë synimet tuaja për vitin 2012?

- Objektivi ynë për vitin 2012 është të vazhdojmë rritjen e shkëlqyer dhe zhvillimin e bankës. Deri më sot, ne jemi brenda objektivave me të gjithë treguesit tanë kyç të performancës dhe unë nuk shoh asnjë arsye pse pjesa tjetër e vitit duhet të jetë ndryshe. Ne, gjithashtu do të vazhdojmë të investojmë në degët tona dhe në shërbimet elektronike bankare,

të lansojmë produkte të reja dhe të përmirësuara, si dhe të ofrojmë shërbime në të gjitha segmentet, për klientët tanë.

#### Si të menaxhohet një bankë në një kohë krize globale financiare, sidomos kur operon në një vend në zhvillim?

Sic e thashë më lart, mjedisi ekonomik krijon sfida dhe pasiguri dhe këto do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit 2012. Megjithatë, një nga përfitimet e të qenit në një vend në zhvillim është se ne nuk kemi një ambient të komplikuar dhe potencialisht të vështirë bankar. Për shembull, sektori bankar nuk është i ekspozuar ndaj borxhit të lartë të qeverisë, apo të kreditimit në valutë, dhe në industrinë bankare në Kosovë, gjithashtu ka nivele të shkëlqyera të likuiditetit, gjë që e bën më të lehtë menaxhimin e një banke këtu, në krahasim me konkurrentët tanë në vende të tjera.

## BKT SYNON TË JETË BANKË E RËNDËSISHME RAJONALE



### SUAT ALBAYRAK

KRYESHEF  
EKZEKUTIV, BANKA  
KOMBËTARE  
TREGTARE (BKT)

#### Si ishte procesi i hyrjes në tregun e Kosovës?

**Cilat ishin sfidat?**  
- Banka Kombëtare Tregtare SH. A. (BKT) është e vetmja bankë shqiptare në Kosovë dhe ka një histori që buron që nga viti 1925. Ajo është themeluar në Shqipëri dhe struktura e saj e tanishme është, pak a shumë, e formuar me bashkimin e dy bankave shtetërore në vitin 1993, Bankës Tregtare Shqiptare dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë. BKT-ja përfundoi procesin e privatizimit në vitin 2000 me investitorët e IFC-së (Korporata Ndërkombëtare Financiare) (20%), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) (20%) dhe Çalik Group 60%. Aksionet e IFC-së dhe EBRD-së janë blerë nga Çalik Financial Services në vitin 2009 dhe ajo tani është 100% aksionare e BKT-së. Dega e BKT-së në Kosovë është regjistruar më 30 gusht të vitit 2007 në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ka filluar të operojë në fund të vitit 2007. Qëllimi kryesor ishte kontribuimi në marrëd-

hëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës. BKT Kosova është banka më e re në vend dhe viti 2009 mund të konsiderohet viti i saj i parë i plotë i veprimit me një rrjet të plotë të degëve. Qytetarët e Kosovës e pranuan BKT-në si një nga bankat e tyre lokale dhe zgjerimi i rrjetit të degëve u shoqërua me një rritje të lartë të pjesës së saj në treg, si në aspektin e kreditimit, po ashtu edhe në atë të depozitave. BKT Kosova ka pozicionuar veten e saj në treg si banka më e mirë për produkte të reja inovative, teknologji, financim të tregut dhe korporatave, kartelave të kreditit dhe po ashtu si një bankë e arsyeshme për sa i përket tarifave të aplikuar ndaj klientëve. Deri më tani duket se këto qëllime edhe janë arritur.

#### Si kanë ndryshuar gjërat pas pesë vjetësh veprimit në këtë treg?

- Dega e BKT-së në Kosovë ka investuar në rrjetin e degëve përgjatë gjithë këtyre viteve. BKT Kosova përjetoi një zgjerim të natyrshëm. Si-

## MENAXHIMI I NJË BANKE VENDASE - PRIVILEGJ DHE PËRGJEGJËSI



### VULLNET LATIFI

KRYESHEF  
EKZEKUTIV, BANKA  
PËR BIZNES

pas kërkesës së klientëve, rrjeti dhe kapacitetet u ngritën. Dega e BKT-së në Kosovë tani ka 23 degë dhe 276 punonjës dhe e mbulon gjithë territorin e Kosovës. Ajo ofron shumëllojshmëri të shërbimeve bankare dhe produkteve moderne. Rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare ishin të kënaqshme.

#### **Cilat janë synimet e Degës së BKT-së në Kosovë për vitin 2012?**

- BKT-ja synon të jetë një bankë e rëndësishme rajonale. Ajo synon të jetë pjesë e rrjetit rajonal si dhe të jetë më e mira në cilësinë e shërbimeve të ofruara në Kosovë. BKT është e përkushtuar ndaj Kosovës me shërbimet e saja dhe veprimtaritë e tjera me përgjegjësi shoqërore. Për Degën e BKT-së në Kosovë, zhvillimi i Kosovës si financiarisht, po ashtu edhe ekonomikisht, është po aq i rëndësishëm sa edhe pasqyrat saj të bilancit. Viti 2012 është një pikë kthese historike për Republikën e Kosovës për sa i përket zhvillimeve ekonomike.

Qeveria lëshoi letrën e parë me vlerë, nënshkroi marrëveshjen me FMN-në (Fondin Monetar Ndërkombëtar); vlerësimi sovran për vendin planifikohet të bëhet gjatë gjysmës së dytë të vitit, Ligji i ri për Banka u miratua. Ne i shohim zhvillimet e këtu si hapa kritikë për një sektor financiar më të zhvilluar në Kosovë. Me një sektor bankar të zhvilluar dhe të rregulluar më mirë, bankat do të jenë në gjendje të kontribuojnë më shumë në rritjen e ekonomisë së Kosovës, si dhe në tregtinë ndërkombëtare dhe do të kenë më shumë mundësi të investimeve kapitale. Në një mjedis të këtu, BKT - Dega e Kosovës do të përpiqet të sjellë shërbimin dhe produktin më të mirë në treg.

#### **Cilat aktivitete e karakterizojnë vitin 2011 dhe cilat janë qëllimet e Bankës për Biznes, për vitin 2012?**

Në bazë të treguesve kryesorë për vitin 2011, mund të themi se performanca e Bankës për Biznes (BpB) ishte e kënaqshme. Pas rritjes së volumit të biznesit, fokusi i BpB-së, po ashtu ishte përmirësimi i proceseve, trajnimi në vazhdimësi i punëtorëve, përmirësimi dhe modifikimi i produkteve sipas nevojës dhe kërkesave të tregut, si dhe ofrimi i një shërbimi dhe kujdesi sa më cilësor për klientët e bankës. Gjatë vitit 2011, Banka ka vazhduar me investimet në infrastrukturë fizike, duke rinovuar dhe/ose hapur njësi të reja. Në Prizren është hapur edhe një njësi e re, në mënyrë që të jemi sa më afër klientëve tanë. Janë rinovuar degët kryesore në Prishtinë, Pejë, Ferizaj dhe në Vushtrri, dhe janë bërë zhvendosjet e degëve në Drenas dhe Viti me të vetmin qëllim, që të jemi aty ku klientët tanë kanë nevojë. Për të qenë në hap me teknologjinë dhe zhvil-

limet në sistemin bankar është vazhduar me implementimin e shërbimeve të reja. Kështu, kartelat VISA, E-banking dhe M-banking, janë bërë mjaft atraktive për klientët tanë, duke iu mundësuar klientëve kryerjen e pagesave të ndryshme, pa pasur nevojë të vijnë në objektet e bankës. SMS Banking është shërbim që ka filluar në gusht të 2011-ës, e i cili përfshinë SMS Notifikimin, SMS Bilancin dhe SMS Top Up. Përdorimi i këtyre shërbimeve bankare ua lehtëson punën, edhe më tepër, klientëve tanë për të qenë të informuar për çdo lëvizje në llogaritë e tyre, në çdo kohë dhe çdo vend. Ndryshime të konsiderueshme dhe përmirësime janë bërë edhe në modulet softuerike, me qëllim të përkrahjes së biznesit të bankës dhe lehtësimin e shërbimeve për klientët. Një zhvillim i rëndësishëm për Bankën për Biznes, por edhe për sektorin bankar si tërësi, ishte nënshkrimi i marrëveshjes për investim në kapital të Bankës në mes të BpB-së dhe Bankës Evropiane për Rindërtim

# Intervista

VAZHDON NGA FAQJA 25

dhe Zhvillim (BERZH). Sipas kësaj marrëveshjeje, në pjesën e dytë të vitit 2011, BERZH-i ka blerë 10% të aksioneve të emetuara të BpB-së dhe në këtë mënyrë është bërë pjesë e strukturës aksionare të bankës. Sa i përket vitit 2012 dhe viteve vijuese, Banka për Biznes është e zotuar të vazhdojë me ecuritë e saja pozitive të rritjes dhe përmirësimet e më-tutjeshme në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që i ofron klientelës së saj. Sikurse deri më tani, BpB do të vazhdojë me avancimin e cilësive të produkteve dhe shërbimeve që do t'i ofrojë në treg, për t'i qëndruar besnik sloganit tanimë të njohur për qytetarët tanë "Mundësi për më shumë". Bizneset, por edhe personat fizikë, do të vazhdojnë të përkrahen në idetë e tyre për të bërë biznes, dhe kështu Banka për Biznes, edhe në vitet vijuese, do të vazhdojë të jetë një lojtar serioz në treg, që në vijimësi ka si synim përkrahjen e bizneseve dhe të qytetarëve, dhe rrjedhimisht, të vazhdojë me kontributin e saj në rritjen ekonomike të vendit.

## **Si është të menaxhosh një bankë me kapital vendas, e cila operon në Kosovë?**

Fillimisht, do të thosha që është një privilegj që të menaxhosh një bankë vendase, por në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësi e lartë, e aq më tepër kur merret parasysh fakti se banka është një institucion i mirëbesimit. Kjo përgjegjësi kërkon një qasje të kujdesshme dhe profesionale, ndaj të gjitha grupeve të interesit, për t'i arritur pritjet e tyre të arsyeshme nga banka. Respektivisht, nëpërmjet rritjes së vlerës duhet të sigurohet një kthim i investimit për aksionarët, krijimi i një ambienti të qëndrueshëm të punës për të gjithë të punësuarit, respektimi i kërkesave ligjore dhe rregullative për shtetin, përfshirë këtu edhe kontributet e ndryshme që ndikojnë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik të Kosovës, dhe së fundi ajo që është më e rëndësishme, i gjithë besimi i klientelës që punojnë me bankën të kthehet me shërbime dhe produkte cilësore, efikase dhe të

sigurta për ta. Menaxhimi i një banke me kapital vendas rrit edhe më tepër përgjegjësinë, ngase aksionarët vendas janë të fokusuar në bizneset e tyre bazë, e që nuk kanë të bëjnë me industrinë bankare, dhe si rrjedhojë bankat me kapital vendas nuk përfitojnë nga sinergjitë e grupeve, siç është rasti me bankat me kapital të huaj, e që janë pjesë e grupacioneve të mëdha. Të qenit vendas mundëson vendime dhe adaptime të shpejta me rrethanat aktuale të tregut dhe ambientit në përgjithësi, duke qenë se janë vazhdimisht në rrjedhë të rrethanave që zhvillohen. Megjithatë, prezenca e EBRD-së në strukturën e aksionarëve të bankës na ka mundësuar, edhe neve që të përfitojmë nga ekspertiza e tyre, nëpërmjet asistencës teknike, të ofruar në fushat ku BpB-ja ka pasur nevojë.

## **Si e shihni ju sektorin bankar në Kosovë pas pesë viteve?**

Me të drejtë mund të thuhet se industria bankare ka qenë një ndër shtori më të suksesshme në Kosovën e pasluftës

dhe që ka pasur një zhvillim pozitiv të vazhdueshëm, nga viti në vit. Fakti që tanimë e gjithë korniza rregullative dhe ligjore mbulon pothuaj të gjitha aktivitetet e industrisë, roli i vazhdueshëm i BQK-së në konsolidimin e mëtejshëm të industrisë nëpërmjet aktivitetit të mbikëqyrjes efektive, si dhe pritjet në përmirësimin e mëtejshëm të ambientit ligjor/respektimi i marrëdhënieve kontraktuale do të ndikojë në përmirësimin e vazhdueshëm të disiplinës financiare dhe si rrjedhojë do të ngrihet performanca e industrisë dhe ambientit të biznesit në përgjithësi. E gjithë kjo do të kontribuojë në ngritjen e vazhdueshme të konkurrencës, qasje më të lehtë në fonde, produkte dhe shërbime cilësore për publikun, duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e tyre për shërbime financiare. Së fundi, jam i bindur që industria bankare edhe në të ardhmen do të jetë një shtyllë e fuqishme e zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik.

Informatat, kur  
janë shumë, duhet  
të organizohen,  
ilustrohen dhe  
renditen në hierarki  
asisoj që secili t'i  
pranojë me sa më  
shumë lehtësi.

—trembelat

TIPOGRAFI  
ARKITEKTURË E DIZAJNIT  
DIZAJN GRAFIK

# Të reja nga bankat

## BKT me një gamë të gjerë shërbimesh

Me më shumë se 85 vjet përvojë në sektorin bankar, Banka Kombëtare Tregtare (BKT) ofron një gamë të gjerë të shërbimeve dhe produkteve bankare për klientët individë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për korporatat.

Llogaria 2 në 1 është produkti më atraktiv në treg, llogari për të cilën nuk paguhet komision, por e shpërblen klientin me 3% interes, si në një llogari kursimi dhe njëkohësisht lejon qasje në llogari gjatë 24 orëve, përmes Debit Kartelave Visa, ose Maestro, në 35 ATM në tërë Kosovën.



Kartat e Kreditit PRIMA MasterCard dhe PRIMA GOLD MasterCard, të lëshuara nga BKT-ja, janë të veçanta sepse, përveç që mundëson blerjen e produkteve përmes internetit, ato gjithashtu ua mundësojnë klientëve blerjen e produkteve dhe shërbimeve, duke kryer pagesat deri në 12 këste në çdo vend, ku shihet logoja e BKT-së Prima Këste. Gjithashtu, me produktin E-Banking, iu ofrohet klientëve menaxhimi i llogarive online në mënyrë të shpejtë, të sigurt, të lehtë dhe pa pagesë. Produkti më i ri i BKT-së është Dega Virtuale e saj në Facebook, ku të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë për të përfituar nga produktet dhe shërbimet bankare në çdo moment dhe kudo që të ndodhen, produkt i cili

ofrohet vetëm nga BKT-ja. Qëlimi i bankës virtuale të BKT-së është që t'iu shërbejë klientëve në mënyrën më të mirë dhe më efikase të mundshme, duke qenë më afër kërkesave të tyre.

## BpB zgjat kredinë deri në tetë vjet

Banka për Biznes (BpB) lanson produktin e ri, i cili klientëve të saj iu sjell mundësi për më shumë. Banka jonë ka vendosur të rrisë kohëzgjatjen e kredisë për persona fizikë nga 60 muaj (5 vjet) sa ka qenë deri më tani, në 96 muaj (8 vjet).

Klientët do të kenë mundësi të shfrytëzojnë këtë kredi për një nevojë të ndryshme personale, siç janë për ndërtim dhe blerje të shtëpisë, blerje të banesës si dhe blerje të truallit për ndërtim. Ne besojmë që kjo risi dukshëm do t'i mbështesë familjet në realizimin e nevojave themelore.

Po ashtu, BpB, si njëra ndër bankat e para në rajon që ka ofruar shërbimin "Mobile Banking", tani përkrah shërbimin e këtij produkti edhe për platformat Android dhe iPhone. Pra, kjo mundësi, tani është e mundur për të gjithë telefonat që kanë GPRS ose WiFi dhe të gjitha platformat e tjera. Ne jemi veçanërisht të kënaqur që me këtë shërbim jemi në pozitë të mbështesim kërkesat specifike të një numri të madh të kosovarëve me standarde moderne botërore, tani lehtësisht të zbatueshme edhe në vendin tonë.

"Mobile Banking" ju lejon qasje të lehtë dhe të sigurt në llogarinë tuaj për të shikuar bilancin,

shumën në dispozicion në kartelë, transferimin e fondeve ndërmjet llogarive tuaja dhe palëve të treta, nga celulari juaj. Në pak fjalë, kjo është struktura juaj e plotë bankare në maje të gishtave tuaj. "Mobile Banking" është në dispozicion në të gjitha rrejetet mobile.



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

## Pagesa e TVSH-së përmes TEB e-Banking

Tani e-banking nga TEB, gjithashtu ofron shërbimin unik të pagesës së TVSH-së, që paraqet një lehtësim të madh për bizneset në Kosovë. Banka TEB ofron shërbimin e-banking që tashmë disa vite dhe ky shërbim mundëson që nëpërmes internetit, klientët të kenë degën e bankës TEB në kompjuterin e tyre, duke u ofruar shumicën e shërbimeve bankare falas dhe shpejt.

Banka TEB ka filluar të ofrojë shërbim unik në platformën e-banking, duke ju mundësuar pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) nga komfori i kompjuterit, kudo dhe kurdo. Pas deklarimit elektronik të tatimit, klienti paguan TVSH-në përmes e-banking, duke kursyer kohën dhe shpenzimet.

Nga TEB e-banking, klienti gjithashtu mund të kontrollojë gjendjen e llogarive, realizon transaksione të ndryshme, menaxhon kartelën Starcard, dhe shumë shërbime të tjera, pa pasur nevojë të vizitohet ndonjëherë nga degët.





FINCA®



**KREDI**

Biznesi  
Rurale  
Grupore  
Renovimi

Qendra e  
thirrjeve:

**045 999 444**

apliko online | [www.finca-ks.org](http://www.finca-ks.org)

FINCA KOSOVË

## ProCredit Bank mbështet bizneset për të stimuluar zhvillim ekonomik

ProCredit Bank përqendrohet në dhënien e kredive për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, meqë është e bindur se këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe stimulojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Duke dashur të jetë çdoherë pranë bizneseve, Pro-Credit Bank i është drejtuar këtij sektori për t'i komunikuar shërbimet bankare të dizajnuara posaçërisht për nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Po ashtu, banka inkurajon bizneset vendore për të bërë investime afatgjata.

Në këtë kontekst, ProCredit Bank është partner lider në tregun bankar të Kosovës. Kjo qasje e bankës është e bazuar në bindjen se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme japin kontribut tejet të çmueshëm në ekonominë e vendit. "Me përkrahjen financiare të Bankës ProCredit, e kemi shtuar makinerinë, ndërsa produktet tona janë shtuar për 70%, duke rritur edhe numrin e punëtorëve. Kjo bankë është një lloj infuzioni për bizneset", thotë Adem Ademi, drejtor i kompanisë për riciklim të plastikës "Ex-Plast".

Prandaj, fokusi është t'iu mundësohet bizneseve të jenë të suksesshme, të përfitojnë nga shërbimet e shpejta dhe shumë cilësore bankare, madje edhe të zgjerojnë biznesin ekzistues në një biznes tjetër të ri, të rrisin profitin, apo të fillojnë me prodhim. ProCredit Bank, krahas kontributit në sektorin bankar, si banka e parë në tregun e pasluftës në Kosovë, njëkohësisht ka kontribuar edhe në zhvillimin e ekonomisë. Që atëherë, shumë biznese kanë realizuar projekte të mëdha afariste me kredi biznesi nga ProCredit Bank.

## Banka e përkushtuar ndaj ambientit - ProCredit Bank

Si institucioni i përgjegjshëm financiar dhe ekologjikisht miqësor, ProCredit Bank ka ndërmarrë fushatë vetëdijësimi në fushën e mbrojtjes mjedisore me moton: "Është Vendi Ynë. Ta Mbajmë Pastër". Me këtë fushatë, ProCredit Bank synon që qasjen e vet proaktive ndaj mjedisit ta shtrijë tutje, duke kontribuar për një mjedis të pastër dhe të gjelbër në Kosovë.

ProCredit Bank beson se kualiteti i jetës, pashmangshëm ka të bëjë me kualitetin e mjedisit ku jetojmë dhe punojmë. Kështu, fushata thekson rëndësinë e të jetuarit në një mjedis të pastër dhe ndikimin në shëndet, gjithnjë duke u bazuar në pikëpamjen se ruajtja e mjedisit është përgjegjësi e gjithë secilit prej



nesh. Për këtë arsye, ProCredit Bank është e përkushtuar në aplikimin e politikave në menaxhimin e ndikimit mjedisor të aktiviteteve të veta operacionale dhe afariste. Në këtë kontekst, banka ka themeluar Komitetin Mjedisor - pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë shoqërore të këtij institucioni financiar. Komiteti Mjedisor mbikëqyr zbatimin e politikave ekologjikisht miqësore, të cilat vazhdimisht avancojnë performancën mjedisore të bankës. Degët e Bankës ProCredit tashmë po ndërtohen me teknologjinë bashkëkohore të shfrytëzimit efikas të energjisë, duke qenë shembull praktik i operimit të ndërtesave të gjelbra në Kosovë. Në fakt, kujdesi ndaj çështjeve mjedisore ka kohë që është artikulluar nga ProCredit Bank - duke qenë banka e parë në Kosovë që ka ofruar Eko-Kredi për kursimin e përdorimit të energjisë për shtëpitë dhe bizneset.

Iniciativa "Është Vendi Ynë. Ta Mbajmë pastër", i adresohet publikut të gjerë, duke zgjeruar tutje qasjen gjithëpërfshirëse të Bankës ProCredit në favor të mjedisit. Kjo iniciativë përmban në vete elemente informimi/ edukimi dhe veprimi. Pjesë përbërëse e kësaj fushate është investimi për hapësira të gjelbra - më saktësisht investimi në hapësira publike të pastruara, në kuadër të nismës qytetare "Ta Pastrojmë Kosovën". Në bashkëpunim me këtë nismë, janë identifikuar një sërë vendesh, të cilat deri në fund të fushatës do të shndërrohen në vende të përshtatshme për qëndrim dhe shfrytëzim nga qytetarët që banojnë në afërsi të tyre. Me rëndësi është që përmes kësaj fushate të japim mesazhin që të gjithë ne, pavarësisht profilit të punës sonë, të kontribuojmë vazhdimisht për një mjedis të pastër dhe të gjelbër në Kosovë.





## Mijëra nxënës marrin pjesë në ProKid kuizin e diturisë

Tridhjetedy shkolla fillore nga të gjitha rajonet e Kosovës garuan me entuziazëm gjatë 11 edicioneve të kuizit të diturisë së Bankës ProCredit – për të marrë titullin dhe shpërblimin e shkollës më të ditur në Kosovë. Nxënësit e shkollës fillore “Migjeni” nga Mitrovica kryesojnë me njohuritë e tyre në biologji, matematikë, gjeografi dhe histori. Ata dëshmuar dijen e tyre gjatë garës edukative me 31 shkolla të tjera, duke fituar në finalen e ProKid Kuizit të Diturisë. Me shpërblimin e fituar, ProCredit Bank do të investojë 4.200 Euro në këtë shkollë për nevojat e identifikuar nga menaxhmenti i shkollës. Kuizi i Diturisë organizohet nga ProCredit Bank për të dytin vit me radhë, duke u bërë ngjarje tradicionale edukative dhe tejet atraktive për nxënësit e Kosovës. Kjo iniciativë reflekton reputacionin e Bankës ProCredit, si bankë që investon në edukim.



## BKT kontribuon në zhvillimin e sportit Kosovor

Përveç dedikimit për prezantimin e produkteve inovative, përgjegjësia shoqërore ka qenë dhe mbetet një prioritet i vazhdueshëm i BKT-së. Si rezultat i kësaj, banka në vazhdimësi ka zhvilluar projekte të lidhura me rininë kosovare. Duke sponsorizuar Superligën e Basketbollit të Kosovës për të dytin vit radhazi, BKT-ja po jep një kontribut të madh në zhvillimin e sportit kosovar. BKT-ja, gjithashtu, ka sponsorizuar garat e kimsë dhe të gjuhës angleze për nxënësit e shkollave të mesme, të organizuara nga shkolla fillore dhe e mesme “Mehmet Akif”, për dy vjet radhazi. Sponsorime të tjera të BKT-së që i kontribuojnë shoqërisë janë: mbrëmja Gala, fondet e grumbulluara të së cilës kanë shkuar në dobi të fëmijëve të sëmurë, sponsorimi i Shoqatës së të Verbërve, sponsorimi në përkrahje të nismës “Ta pas-trojmë Kosovën” etj. Konceptit të Bankës Kombëtare Tregtare për përgjegjësi shoqërore në bazë të motos “Kontribuo për shoqërinë” i ka shërbyer ofrimi i produkteve dhe shërbimeve cilësore, krijimi i mundësive për punësim, duke iu ofruar punonjësve të saj kushte optimale për ushtrimin e detyrës së tyre.

## Olimpiada e matematikës

Gjashtë nxënës nga Kosova, fitues të Olimpiadës së sivjetme të Matematikës, do ta përfaqësojnë vendin në garën ndërkombëtare të matematikës, e cila do të mbahet në Argjentinë, në muajin korrik. Gjithsej dyqind nxënës nga të gjitha rajonet e Kosovës kanë garuar në Olimpiadën e përkrahur nga ProCredit Bank, për t'u klasifikuar në mesin e gjashtë matematikanëve më të mirë parauniversitarë.

# Qendra e Trajnimeve e Shoqatës së Bankave

**QENDRA E TRAJNIMEVE** e Shoqatës së Bankave është themeluar në vitin 2005 dhe ka luajtur rol aktiv në procesin e zhvillimit të sektorit bankar, që në fazën e hershme të themelimit të saj, duke trajnuar rreth një të tretën e punëtorëve të përgjithshëm të sektorit, gjatë viteve 2004-2005. Roli i trajnimeve në SHBK është që të plotësojë nevojat e sektorit në edukim bankar, duke ofruar trajnime për të gjithë ata, të cilët dëshirojnë të fitojnë njohuri në fushën e bankave dhe të financave. Sot, duke i falënderuar anëtarëve për interesimin në trajnimet tona, Qendra për Trajnime Bankare mban rregullisht trajnime të thurura sipas nevojave të bankave anëtare, dhe nevojave të industrisë financiare në përgjithësi. Qendra e Trajnimeve Bankare, sot është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës, e cila ndihmon zhvillimin e sistemit modern të shërbimeve financiare dhe është bërë burimi kryesor i trajnimit praktik dhe teorik për bankierët në Kosovë.

Trajnimi i stafit, përveçse përmirëson performancën, gjithashtu është edhe një ndër motivuesit kryesor të stafit, pasi që iu mundëson individëve të përparojnë dhe të zhvillohen profesionalisht dhe kështu të ngrisin nivelin e tyre profesional. Kurset e trajnimit variojnë nga ato me programe të avancuara, ashtu që të përmbushin nevojat specifike të punëtorëve me përvojë në banka, deri tek niveli fillestar, i cili ofron njohuri të përgjithshme dhe bazike.

Shoqata e Bankave të Kosovës, aktualisht bashkëpunon me disa institucione vendore dhe të huaja, për sa i përket fushës së trajnimeve. Ndër to veçohen Banka Botërore, Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia për Transfer të Teknologjisë Financiare (Agence de Transfert de Technologie Financiere – ATTF) në Luksemburg. Gjithashtu, SHBK është anëtare e akredituar nga Rrjeti Evropian për Trajnime Bankare (European Bank Training Network - EBTN) me seli në Bruksel, për të zbatuar certifikimin e kandidatëve në Programin e Certifikimit EFCB.

Trajnimet mbahen nga ekspertë të vendit dhe ndërkombëtarë, me përvojë në fushën bankare dhe në universitete, duke inkorporuar kështu përvojën dhe njohuritë e vendit me përvojën dhe praktikën e vendeve të zhvilluara.

## **Certifikimi Bazat e Afarizmit Bankar - EFCB**

Në vitin 2012, Qendra për Trajnime Bankare në Kosovë ka filluar për të parën herë të mbajë kursin përgatitor dhe testin e certifikimit për programin Certifikimi Bazat e Afarizmit Bankar / European Foundation Certificate in Banking (EFCB).



EFCB është një program trajnimi dhe certifikimi i njohurive bankare, i themeluar nga Rrjeti Evropian për Trajnime Bankare (European Bank Training Network – EBTN) me seli në Bruksel - institucion ky i përbërë nga institutet e edukimit bankar të Evropës dhe nga disa shtete të tjera në Azi, Afrikë dhe Australi. Në tetor të vitit 2011, SHBK-ja është akredituar nga Rrjeti Evropian për Trajnime Bankare që të mbajë kurse dhe të certifikojë kandidatët. Me këtë rast, SHBK-ja bëhet institucioni i pesëmbëdhjetë që ka arritur të akreditohet dhe të ofrojë këtë program certifikimi, duke tejkaluar vendet e rajonit, përderisa certifikatat njihen dhe pranohen në Evropë dhe në disa shtete të tjera në Afrikë, Azi dhe Australi.

## **Pse EFCB?**

Fillimisht, i tërë projekti është iniciuar për të plotësuar individët me njohuri shtesë dhe shembuj praktikë nga puna e përditshme që kërkohet në bankat tona, si dhe për të krijuar një sistem uniform të vlerësimit të kualifikimeve dhe aftësive në fushën e bankave.

Duke vendosur standarde më të prekshme, kjo i mundëson bankave që të njohin më saktësisht aftësitë e individëve që aplikojnë për punë, e në këtë mënyrë të bëjnë edhe përzgjedhjen e kandidatit adekuat dhe më të kualifikuar.

## **Përfitimet**

Programi ofron benefite në disa rrafshë. Në njërën anë iu mundëson punëtorëve të ardhshëm të sektorit bankar që të jenë më të përgatitur me njohuri për të filluar punën në banka, duke mësuar rreth gjërave konkrete që janë me interes për punëdhënësin e tyre. Po ashtu, certifikatat njihen dhe janë në përputhje me kualifikimet që kërkohen edhe në vendet e zhvilluara të Evropës, si dhe në 40 shtete tjera të botës, ku Certifikimi EFCB është i pranueshëm.

Nga ana tjetër, bankave iu mundëson që të kenë një sistem uniform dhe të kontrollueshëm të njohurive dhe aftësive bankare; duke e bërë më të lehtë vlerësimin e njohurive bankare të kandidatëve.

Duke qenë se prej fillimit të projektit, bankat kanë qenë të përfshira në zhvillimin dhe ngritjen e programit, ky është një garantues i fortë që ky program plotëson me të vërtetë nevojat e njohurive që kërkohen për personel fillestar të bankave.

Programi EFCB iu dedikohet të gjithë atyre që dëshirojnë të fillojnë karrierë në banka, apo që tashmë janë staf i bankave, dhe dëshirojnë të gradohen më lartë në pozitë.

Certifikimi EFCB përfshin të gjitha aspektet e punës në një institucion bankar, dhe ofron njohuri bazike të transferuara si në teori, ashtu dhe në praktikë, nga ligjërues që njohin temat përkatëse, si dhe i praktikojnë këto njohuri në institucionet ku punojnë.

Duke nisur nga 15 tetori 2012, SHBK-ja do të fillojë të ofrojë këtë certifikim edhe për individë jashtë bankave, dhe për publikun e gjerë. Pjesëmarrës do të jenë studentët e individë të interesuar për karrierë në banka. Tashmë janë plotësuar gjysma e vendeve për grupin e radhës, të gjithë studentët të fushës së ekonomisë, apo të diplomuar të papunë.

### **Programi**

**MODULI A: AMBIENTI EKONOMIK DHE MONETAR**  
Struktura Ekonomike dhe Financiare e Evropës  
Politikat Monetare të Evropës

**MODULI B: MARRËDHËNIA KLIENT – PRODUKT**  
Produktet, Klientët, Distribrimi dhe Konkurrenca  
Klientët me pakicë  
Klientët korporata  
Klientët institucional  
Menaxhimi nevojave, risqeve dhe kostos  
Mikrofinancat

**MODULI C: ASPEKTET NJERËZORE**  
Etika në banka  
Marketingu  
Menaxhimi burimeve njerëzore  
Menaxhimi përgjithshëm në banka

Pra, duke filluar nga sistemi dhe politikat monetare lokale, sikurse dhe ato evropiane; pastaj produktet dhe klientët, si dhe marrëdhënia mes tyre, segmentimi; menaxhimi i thesarit, risqeve dhe kostos; aspektet njerëzore si etika, marketingu, burimet njerëzore dhe menaxhimi i përgjithshëm - programi EFCB përfshin një gamë të gjerë të aktiviteve në banka.

Ligjëruesit vijnë nga departamente përkatëse të bankave dhe janë trajnerë me përvojë në fushën e trajnimeve bankare, si dhe ekspertë që praktikojnë këto mësim, çdo ditë, në vendet e tyre të punës.

Në muajin prill, me sukses kanë përfunduar kursin trembëdhjetë kandidatët e parë në këtë periudhë, dhe që të gjithë staf ekzistues i bankave komerciale në Kosovë – të cilët i janë nënshtruar tashmë testit të certifikimit më datën 18 maj. Certifikatat do të lëshohen nga Rrjeti Evropian për Trajnime Bankare (EBTN) me seli në Bruksel.

### **Trajnimet gjatë vitit 2012**

Gjatë vitit 2012 janë paraparë një sërë trajnimesh që kanë rrjedhur si nevojë për zhvillim të stafit të anëtarëve tanë, apo si rezultat i rrethanave të krijuara ndërkohë, si dhe ndryshimet në rregullimin dhe standartet ndërkombëtare financiare në botë.

### **Trajnimet e mbajtura me sukses këtë vit:**

Matematikë dhe MS Excel në Aplikimet Financiare  
Tatimet - Nivel i Avancuar  
IFRS Introductory  
IFRS Intermediate  
IFRS Advanced  
Lidership dhe Formim të Ekipeve (Team Bulding)  
Certifikimi EFCB

### **Trajnimet në vijim do të ofrohen në kuadër të programit të vjeshtës:**

Detektimi, Parandalimi dhe Hetimi i Mashtrimit për Auditorë të Brendshëm  
Aftësitë Menaxheriale  
Marketingu, Planifikimi i Marketingut dhe Mjetet për Hulumtim  
Menaxhimi i Riskut Operacional  
Basel II dhe e Ardhmja e Rregullimit Bankar  
Afarizmi Bankar me Klientë Privatë (me pakicë)  
Certifikimi EFCB

### **Libraria**

Një ndër aktivitetet e Qendrës së Trajnimeve është edhe ofrimi i literaturës dhe materialeve të ndryshme edukative për nevojat e anëtarëve tanë. Aktualisht libraria jonë përmban dhjetëra tituj të librave dhe manualeve të trajnimit, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Pjesa dërrmuese e titujve janë nga autorë botërorë dhe ekspertë të njohur nga fusha a bankave dhe e financave.

Libraria e Qendrës së Trajnimeve është e hapur për të gjithë anëtarët tanë. Materiali të cilin e përmban kjo librari mbulon kryesisht fusha nga Financat dhe Kontabiliteti, Menaxhimi i Rrezikut, Auditimi, Menaxhimi i Biznesit, Ekonomia, Marketingu, Menaxhimi i Operacioneve, Udhëheqja etj. Librat janë të organizuara sipas fushës përkatëse.

Librat mund të huazohen nga Qendra e Trajnimeve për një periudhë deri në 30 ditë, pasi të jetë regjistruar individi në librarinë e Shoqatës së Bankave të Kosovës.

## Tryezë e rrumbullakët - Hipoteka si titull ekzekutiv

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK), në bashkëpunim me Sistemin për Përmbarrimin e Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD USAID), si dhe Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (AmCham), organizuan tryezën e rrumbullakët për procedurën e përmbarrimit të hipotekave, me datën 28 shkurt 2012. Në këtë tryezë pati fjalime nga z. David Greer, drejtor i Programit të USAID-it, Sistemi për Përmbarrimin e Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD), i cili potencoi rëndësinë ekonomike dhe ligjore të kësaj teme. Fjalime ka pasur edhe nga z. Fejzullah Hasani, kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; z. Dastid Palaska, sekretar i Përgjithshëm i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (AmCham), si dhe nga z. Robert Wright, kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK). Në këtë tryezë u theksua se sa më shpejt dhe me efikasitet që të ekzekutohet një kontratë, atëherë aq më mirë është për shoqërinë dhe ekonominë në vend. Në këtë tryezë të rrumbullakët, po ashtu, u theksua rëndësia e interpretimit dhe aplikimit uniform të ligjit në të gjithë vendin dhe u bë e kuptueshme se të gjitha palët janë në favor të trajtimit të kontratës së hipotekës si titull ekzekutiv. Në diskutim u fol edhe për hapat e ardhshëm që duhet të merren në këtë drejtim dhe u theksua se duhet të vazhdohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, si dhe të vazhdojnë diskutimet e brendshme.

## Certifikimi Bazat e Afarizmit Bankar

Programi BAB (Bazat e Afarizmit Bankar) është program i certifikimit në njohuri themelore bankare, i ngritur nga Rrjeti Evropian për Trajnime Bankare (European Bank Training Network, EBTN). I mbështetur dhe i menaxhuar nga vetë sektori bankar i Kosovës, programi Bazat e Af-



Tryezë e rrumbullakët - Hipoteka si titull ekzekutiv



SHBK Merr Pjesë në Panairin e Karrierës

arizmit Bankar - BAB, i akredituar në bazë të standardeve të EFCB (European Foundation Certificate in Banking), aftëson dhe certifikon personat për njohuri fundamentale në banka, me qëllim që të kenë njohuri dhe përparësi me rastin e aplikimit për punë në banka. Akreditimi nga EBTN mundëson që këto certifikata të njihen dhe të përdoren në shtetet evropiane, disa prej të cilave veç e kanë adaptuar programin EFCB. Më datën 19 mars 2012, filloi grupi i parë i këtij programi i përbërë nga zyrtarë të bankave të cilët janë pjesë e departamenteve të ndryshme, si: analistë të kredive, këshilltarë për klientë, arkëtarë, specialistë të burimeve njerëzore, zyrtarë për kartela, zyrtarë për marrëdhënie me korporata, zyrtarë për klasifikim të aseteve, pjesëmarrës nga programi për bankierë të rinj, e kështu me radhë. Më datën 25 prill 2012, përfundoi kursin grupi i parë për Certifikimin EFCB, apo Bazat e Afarizmit Bankar, dhe iu nënshtrua provimit të certifikimit më 19 maj 2012. Në fund të kursit 15-ditor, pjesëmarrësit i shprehën se ky tra-

jnim iu ka dhënë njohuri shtesë rreth punës së përgjithshme në banka, e sidomos për pjesët e operacioneve të ndryshme bankare, që normalisht nuk lidhen me punën e tyre të përditshme, duke shtuar se ata kanë freskuar me informata praktike njohuritë rreth punës së përditshme të cilën e ushtrojnë në institucionet ku ata punojnë.

## SHBK merr pjesë në panairin e karrierës

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) u ekspozua në Panairin e Karrierës, i cili u organizua për herë të dytë nga Qendra për Zhvillimin e Karrierës të Universitetit të Prishtinës. Ky panair u mbajt në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, ku morën pjesë një numër i madh i studentëve, të cilët shprehën interesimin e tyre për punë praktike në kompani të ndryshme dhe institucioneve, gjë e cila do t'u ndihmonte atyre për punësim afatgjatë në të ardhmen. SHBK në këtë panair u prezantua me programin e certifikimit EFCB, apo Bazat e Afarizmit Bankar, me ç'rast u shpalosën përfitimet e këtij programi dhe ecuria e tij. Një numër i konsiderueshëm i të pranishmëve në këtë panair u interesua për ndjekjen e këtij programi, i cili do t'u shërbejë këtyre pjesëmarrësve si një avantazh në aplikimin e tyre për punë në banka. Prandaj, ky panair u karakterizua si i suksesshëm, për shkak të numrit të madh të vizitorëve dhe të interesuarve për institucionet dhe kompanitë ekspozuese.

# Bazat e Afarizmit Bankar | EFCB

*European Foundation  
Certificate in Banking*

fitoni njohuri dhe certifikatë fundamentale bankare

krijoni vetes përparësi gjatë rekrutimit në banka

përfitoni nga certifikata e njohur ndërkombëtarisht



*Kursi përgatitor fillon:*  
**15 Tetor, 2012**

*Afati i fundit për regjistrim:*  
**1 Shtator, 2012**

\*vendet janë të kufizuara

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit,  
kontaktoni Qendrën e Trajnimeve në Shoqatën e Bankave të  
Kosovës:

- 038 246 171
- [kbatraining@bankassoc-kos.com](mailto:kbatraining@bankassoc-kos.com)
- [www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)



## Panairi Financiar 2012

Panairi Financiar është një ndër ngjarjet më të rëndësishme për sektorin financiar. Ky panair organizohet me qëllimin që të mbledhë ekspozues që kanë të bëjnë me veprimtarinë financiare dhe sektorin bankar, si dhe pjesëmarrës apo vizitorë me prapavijë të ndryshme. Panairi Financiar iu mundëson bankave dhe institucioneve tjera financiare që të prezantojnë produktet e tyre dhe të komunikojnë me klientë, vendimmarrës, media, dhe investitor të ndryshëm.

Pjesën kryesore të këtij panairi, përveç ekspozimit, e përbëjnë edhe konferencat e ndryshme që organizohen në kuadër të panairit, të cilat përfshijnë tema shumë të rëndësishme, me ç'rast ekspertë të ndryshëm diskutojnë për çështje të sektorit bankar dhe për ekonominë në përgjithësi.

Këtë vit, Panairi Financiar do të mbahet në muajin shtator. Interesimin tuaj për pjesëmarrje mund ta paraqisni përmes e-mailit: [panairifinanciar@bankasoc-kos.com](mailto:panairifinanciar@bankasoc-kos.com). Shpresojmë të bëheni pjesë e kësaj ngjarjeje të rëndësishme financiare dhe të kontribuoni në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori!



## Plani i Trajnimeve për Vjeshtë 2012

Detektimi, Parandalimi dhe Hetimi i Mashtrimit për Auditorë të Brendshëm;  
Aftësitë Menaxheriale;  
Marketingu, Planifikimi i Marketingut dhe Mjetet për Hulumtim;  
Menaxhimi i Riskut Operacional;  
Basel II;  
Afarizmi Bankar me Klientë Privatë (me pakicë);  
Auditim dhe Kontroll i Brendshëm;  
Certifikimi EFCB.

MARKETING



**ARIZONA**  
P A R T N E R S

accounting, tax & consulting

[www.arizona-partners.com](http://www.arizona-partners.com)

**KE KOHË...**

Shfrytëzoni shërbimet  
**ELEKTRONIKE**

Sot, koha është shumë e çmueshme dhe gjithmonë mundohemi që ta ruajmë atë për gjëra të rëndësishme.

Në bankën Raiffeisen ne çmojmë kohën tuaj dhe për këtë shkak kemi investuar në krijimin dhe avancimin e produkteve dhe shërbimeve elektronike, përmes së cilave ju kryeni shumicën e punëve, sikur të ishit në bankë.

Që të keni më shumë kohë për gjëra tjera, shfrytëzoni shërbimet elektronike, të cilat i keni **në kuadër të pakove të llogarisë rrjedhëse:**

**E-banking | m-banking | SMS njoftimi | SMS Top Up | Kartelat**

Dhe, pastaj përnime ke kohë, ke kohë edhe me shti truza n'pe...



**038 222 222**

[www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com)  
[info@raiffeisen-kosovo.com](mailto:info@raiffeisen-kosovo.com)

# DEGA VIRTUALE E BKT-së në **facebook**

Në çdo kohë ju mund të:

- filloni procesin e Hapjes së Llogarisë;
- aplikoni për Kredi Individuale;
- aplikoni për Kredit Kartën PRIMA;
- komunikoni me Bankën;

**Apliko**  
Aty për aty



038 666 666 | [www.bkt-ks.com](http://www.bkt-ks.com)

 [www.facebook.com/BKTKosova](https://www.facebook.com/BKTKosova)

